



Rrjeti i Asociacioneve  
të Autoriteteve Lokale  
të Evropës Juglindore

RAPORT

RAPORT

RAPORT

RAPORT

RAPORT

RAPORT

RAPORT

RAPORT

Studim krahasimor i menaxhimit  
**të mbeturinave të ngurta**  
në Evropën Juglindore, **2014**





# RAPORT



## Studim krahasimor i menaxhimit të mbeturinave të ngurta në Evropën Juglindore

---

Botimi i parë  
Mars 2016

2014

**CIP** - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

628.4:005.5(4-12)"2014"(047)

BENCHMARKING on solid waste management in South-east Europe :  
report : 2014 / [authors Sanda Midzic Kurtagic ... [и др.]. -  
Skopje : Network of Associations of Local Authorities of South-East  
Europe - NALAS, 2016. - 66 стр. : граф. прикази ; 21 см

Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4680-07-9

1. Midzic Kurtagic, Sanda [автор]

а) Цврст отпад - Управување - Југоисточна Европа - 2014 - Извештаи

COBISS.MK-ID 100905738

# PËRMBAJTJA

<b>Pasqyrë e shkurtër mbi raportin.....</b>	<b>5</b>
<b>1 Hyrje.....</b>	<b>7</b>
1.1 Hyrje në studimin krahasimor të MMN në EJL.....	7
1.2 Metodologjia e hulumtimit.....	8
<b>2 Pasqyrë e përgjithshme e qeverive lokale në Evropën Juglindore.....</b>	<b>11</b>
<b>3 Rishikimet e menaxhimit të mbeturinave të ngurta në nivel shtetëror.....</b>	<b>15</b>
3.1 Shqipëria.....	16
3.2 Bosna dhe Hercegovina.....	17
3.3 Bullgaria.....	19
3.4 Kosova.....	21
3.5 Maqedonia.....	22
3.6 Moldavia.....	23
3.7 Mali i Zi.....	25
3.8 Rumania.....	26
3.9 Serbia.....	27
3.10 Turqia.....	28
3.11 Studim krahasimor i indikatorëve të nivelit shtetëror për MMN.....	30
<b>4 Rishikimi i menaxhimit të mbeturinave të ngurta në komuna.....</b>	<b>37</b>
4.1 Komuna e Lezhës (Shqipëri).....	38
4.2 Komuna Prijedor (Bosne dhe Hercegovinë).....	40
4.3 Komuna Cazin (Bosne dhe Hercegovinë).....	42
4.4 Komuna Gabrovo (Bullgari).....	44
4.5 Komuna Bijelo Polje (Mali i Zi).....	46
4.6 Komuna e Ferizajt (Kosovë).....	48
4.7 Komuna e Kumanovës (Maqedoni).....	50
4.8 Komuna Pančevo (Serbi).....	52
4.9 Komuna Uzunköprü (Turqi).....	54
4.10 Komuna Targoviste (Rumani).....	56
4.11 Komuna Soldanesti (Moldavi).....	57
4.12 Studim krahasimor i indikatorëve të nivelit lokal për MMN.....	58
<b>ORGANIZATAT PARTNERE.....</b>	<b>65</b>

## **Ky raport është rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të Task Forcës NALAS për Menaxhimin e Mbeturinave të Ngurta dhe Ujërave (TF SWWM)**

### **Autorët sipas rendit alfabetik:**

Sanda Midzic Kurtagic, Eksperte regjionale për menaxhimin e mbeturinave të ngurta dhe  
Adrian MIROIU-LAMBA, përfaqësues i Asociacionit të Komunave të Rumanisë  
Agron HAXHIMALI, përfaqësues i Asociacionit të Komunave të Shqipërisë  
Ahmet Cihat KAHRAMAN, përfaqësues i Unionit të komunave të rajonit Marmara  
Boban BOJKOVSKI, përfaqësues i Asociacionit ZELS –të Njësive të vetëqeverisjes lokale të Republikës së Maqedonisë  
Danijela DJUROVIC, përfaqësuese e Unionit të Komunave të Malit të Zi  
Desislava STOYKOVA, përfaqësuese e Asociacionit Nacional të Komunave të Republikës së Bullgarisë  
Dragan LAZIC, përfaqësues i Asociacionit të Qyteteve dhe Komunave të Republikës Srpska  
Gani BERISHA, përfaqësues i Asociacionit të Komunave të Kosovës  
Irem SILAJDZIC, përfaqësues i Asociacionit të Komunave dhe Qyteteve të Federatës së BH-së  
Irina LUNCASU, përfaqësuese e Kongresit të Autoriteteve Lokale të Moldavisë  
Miodrag GLUSCEVIC, përfaqësues i Konferencës së Përhershme të Qyteteve dhe Komunave

### **Mbështetur nga:**

Konferenca e përhershme e Qyteteve dhe Komunave të Serbisë -  
Asociacioni Drejtues i Task Forcës NALAS për menaxhimin e mbeturinave të ngurta dhe ujërave  
Zajazi Kelmend, Drejtor ekzekutiv i NALAS-it  
Ivanoski Boran, Zyrtar projekti nëNALAS  
Sekretariati i NALAS-it

### **Dizajni nga:**

Brigada Design, Shkup

Raporti është përgatitur si aktivitet i zbatuar gjatë “ grumbullimit të të dhënave përmbeturinat e ngurta në Evropën Juglindore” projekt i zbatuar nga NALAS, Aquasan dhe SeSWA. Projekti është mbështetur financiarisht nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) dhe Qeveria Zvicerane si dhe është zbatuar nga GIZ përmes Fondit të tyre të hapur rajonal për Modernizim të Shërbimeve Komunale (ORF MMS).

# PASQYRË E SHKURTËR MBI RAPORTIN

Shtetet e Evropës Juglindore (EJL) të përfshira në këtë Raport nuk kanë të vendosur ndonjë sistem të grumbullimit të të dhënave ose përpunimit të indikatorëve edhe pse grumbullimi i të dhënave dhe sistemi informativ i menaxhimit të mbeturinave të ngurta janë të rregulluara ligjërisht. Ka disa të dhëna të cilat janë të disponueshme në nivel shtetëror si pjesë e statistikave shtetërore ose raportimit mbi statusin mjedisor dhe raportimit për Agjencinë Evropiane Mjedisore. Megjithatë, shumica e indikatorëve bazohen në shifra të projektuara.

- ▲ Cilësia e të dhënave të menaxhimit të mbeturinave të ngurta vihet në pyetje dhe krijon vështirësi menaxheriale për shërbimet komunale, komunat dhe autoritetet tjera shtetërore relevante.
- ▲ Zyrat statistikore shtetërore, të cilatdo prej shteteve, nuk sigurojnë ndonjë shifër për përbërjen e mbeturinave. Serbia është shteti i vetëm që e ka rregulluar obligimin e vet për të përcaktuar sasinë dhe përbërjen e mbeturinave si dhe metodologjinë e përbashkët. Në komunat e shteteve tjera të Ballkanit Perëndimor, aplikohet e njëjta metodologji si pjesë e pilot projektit.
- ▲ Indikatorit i gjenerimit të mbeturinave të ngurta në nivel shtetëror në shumicën e shteteve (përveç Rumanisë)

është nën mesataren 28 të BE-së, që ishte 1,2 kg/ditë për kokë banori për vitin 2014. Ky indikator është ngushtë i lidhur me nivelin e Bruto Produktit Vendor (BPV). Turqia, Mali i Zi dhe Rumania, shtetet me BPV-në më të lartë prej shteteve që janë observuar, kanë gjenerim të mbeturinave prej 1.1 dhe 1.5 kg/ditë për kokë banori.

- ▲ Kryesisht mbeturinat hedhen në deponi. Riciklimi dhe rikthimi material duke përfshirë kompostimin dhe rikthimin e energjisë, bëhen rrallëherë. Mbeturinat e rikthyer përmes riciklimit nuk i tejkalojnë 10%.
- ▲ Kompostimi bëhet vetëm në Rumani. Këto shtete kanë zona të mëdha rurale me mbulim të ulët të MMN-së kështu që kompostimi shtëpiak që do të mund të aplikohet me kosto minimale ka potencial të fuqishëm. Gjithashtu, mund t'i kontribuojë reduktimit të mbeturinave të biodegradueshme në deponi.
- ▲ Opsionet e trajtimit të vogël mekanik-biologjik përdoren në Bosnje dhe Hercegovinë dhe Turqi. Trajtimi termik i mbeturinave të ngurta komunale përdoret si opsion në Turqi. Mbeturinat e përdorura në termocentrale kërkojnë furnizim të vazhdueshëm të sasive specifike të mbeturinave, gjë që nuk mund të realizohet në pjesën më të madhe të shteteve.

- ▶ Përkundër modernizimit të MMN-së në Bashkimin Evropian gjatë dekadave të fundit, rajoni i EJL ende po vuan nga praktikat e paqëndrueshme të menaxhimit të mbeturinave duke përfshirë deponimin e hapur etj.
- ▶ Në nivel komunal, të dhënat për mbeturinat e ngurta nuk grumbullohen rregullisht. Shërbimet komunale të cilat sigurojnë grumbullimin e mbeturinave të ngurta dhe shërbimet e përpunimit nuk kanë të dhëna të besueshme dhe të sakta për sa i përket sasisë dhe përbërjes së mbeturinave shtëpiake të prodhuara nga banorët. Në shumicën e rasteve, përbërja e mbeturinave është e supozuar dhe nuk mund të merret parasysh për qëllime të vendimmarrjes në nivel lokal. Disa pilot komuna kanë mungesë të të dhënave për gjenerimin e MNK, mbulimin e shërbimit dhe përqindjet e riciklimit.
- ▶ Mbulimi i shërbimit të MNK në zona rurale të komunave të selektuara nuk është i kënaqshëm. Mbulimi i shërbimit të MNK nuk është nën 80% në zona urbane. Në shumicën e rasteve zonat urbane janë shumë më të vogla se ato rurale.
- ▶ Mbeturinat e kopshteve dhe mbeturinat tjera të biodegradueshme që kanë potencial të madh për rikthim përbëjnë nga 25-70% të pjesës më të madhe të MNK. Në shumicën e rasteve hidhen në deponi komunale.
- ▶ Sasitë e letrës dhe kartuçit, të gjeneruara në shumicën e komunave të vrojtuar, nuk janë të mëdha, kështu që vëhjet në pyetje mundësia e zhvillimit të një sistemi gjithëpërfshirës publik për grumbullim, transport dhe riciklim të komponentëve të tillë. E njëjta mund të thuhet për plastikë. Megjithatë, prezenca e grumbulluesve të mbeturinave dhe ndërmarrjeve të vogla të riciklimit dëshmon se rikthimi i mbeturinave ka potencial ekonomik dhe është interesant për kompanitë e vogla.



# HYRJE

# 1

**K**y raport prezanton rezultatet e studimit krahasimor të menaxhimit të mbeturinave të ngurta për shtetet e Evropës Juglindore, të ofruara nga anëtarët e Task Forcës për Menaxhim të Mbeturinave të Ngurta dhe Ujërave brenda Rrjetit të Asociacioneve të Autoriteteve Lokale në Evropën Juglindore (NALAS).

Synimi i këtij studimi ishte identifikimi dhe analizimi i indikatorëve kuantitativ dhe kualitativ të MMN, duke mbuluar aspektet e MMN sikurse janë gjenerimi i mbeturinave, mbulimi i shërbimit, shkalla deri në të cilën rikthehen/riciklohen mbeturinat e ngurta komunale, efikasiteti në relacion me caqet e deponimit etj.

## 1.1 Hyrje në studimin krahasimor të MMN në EJL

Studimi krahasimor është praktikë e zakonshme dhe ushtrim i ndjeshëm për përcaktim të bazës, definim të praktikave më të mira dhe identifikim të mundësive për përmirësime. Studimi krahasimor duhet të bëhet në nivel shtetëror, lokal dhe në nivel të shërbimeve komunale publike të MMN. Indikatorët shtetëror të studimit krahasimor tregojnë situatën bazike në nivelin shtetëror dhe do të mundësojnë krahasimin rajonal dhe matjen e arritjeve të shtetit drejt një numri të caqeve ndërkombëtare sikurse janë caqet e BE-së për MMN të paraqitura në Direktivën 2008 /98/EC mbi mbeturinat (Direktiva Kornizë për Mbeturina). Direktivat e BE-së për Mbeturina janë caqet të detyrueshme për shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet në proces të anëtarësimit në BE në rajonin e EJL.

Grupi i indikatorëve shtetëror të studimit krahasimor përshkruan situatën e zakonshme në nivel shtetëror përderisa, në praktikë, vlera e këtyre indikatorëve dallon prej një komune në tjetrën, brenda të njëjtit shtet. Në komuna me status të ndryshëm ekonomik, dallojnë raportet e popullatës dhe zonës urbane-rurale, sasia dhe përbërja e mbeturinave. Pasi që autoritetet lokale janë përgjegjëse për MMN, ekziston një arsye legjitime për realizim të studimit krahasimor edhe në nivel komunal lokal. Autoritetet lokale shpeshherë ballafaqohen me fonde të kufizuara për zhvillimin e infrastrukturës komunale të MMN, përderisa shërbimet lokale publike të MMN ballafaqohen me të ardhura të reduktuara nga ofrimi i shërbimeve të tyre. Studimi krahasimor në nivel komunal do të sigurojë informata për vendimmarrje mbi prioritetet e fondeve të kufizuara, të disponueshme për përmirësime të shërbimeve dhe do të mundësojë monitorimin e ndryshimeve gjatë kohës.

Përveç kësaj, indikatorët ndërkombëtarisht konsistent, të cilët mundësojnë krahasimin e performancës së komunave, pa marrë parasysh nivelin e të ardhurave të tyre, janë të dobishëm në kontekste të ndryshme, duke përfshirë, për shembull, përpjekjet për bashkëpunim që synojnë mbrojtjen më të mirë të shëndetit publik dhe mjedisit, rikthimin e rritur të burimit dhe një qeverisje<sup>1</sup> më të mirë urbane.

Realizimi i studimit krahasimor NALAS për menaxhimin e mbeturinave të ngurta do t'i ndihmojë anëtarët e NALAS-it – asociacionet e pushtetit lokal në shtetet e rajonit EJL të

<sup>1</sup> D.C. Wilson et al./Analizat krahasuese të MMN në 20 qytete, Menaxhimi i mbeturinave & hulumtime 2012, 30(3), 237-25.)

fitojnë një perspektivë të pavarur se sa mirë bëhet MMN në krahasim me shtetet dhe komunat tjera. Identifikon qartë fushat specifike të mundësisë, priorizon mundësitë për përmirësime, vendosë pritjet për performancë dhe monitoron ndryshimet në nivel të rajonit të EJL. Mbi të gjitha, ka të bëjë me menaxhimin e mbeturinave të ngurta në një mënyrë të përgjegjshme sociale, mjedisore dhe financiare.

## 1.2 Metodologjia e hulumtimit

Studimi krahasimor i menaxhimit të mbeturinave të ngurta është bërë në 10 shtete<sup>2</sup> të EJL të përfshira në rrjetin NALAS. Ai ishte fokusuar në nivelin më të ulët të qeverisë nënsovrane që do të thotë qeverive komunale të zgjedhura në bazë të parimit të demokracisë.

Për këtë qëllim, 11 pilot komuna me popullsi ndërmjet 35,000 dhe 125,000 janë selektuar dhe përfshirë në studimin krahasimor.

**Tabela 1:** Pilot komunat e përfshira në studimin krahasimor

SHTETI	QYTETI/KOMUNA	POPULLSIA
Shqipëria	Lezha	107,873
Bosna dhe Hercegovina	Prijedor	97,588
	Cazin	69,411
Bullgari	Gabrovo	60,772
Mali i Zi	Bijelo Polje	46,051
Kosova <sup>3</sup>	Ferizaj	108,610
Maqedonia	Kumanovë	108,048
Serbi	Pančevo	122,252
Turqia	Uzunköprü	64,312
Rumunia	Targoviște	89,000
Moldavia	Soldanesti	37,774

<sup>2</sup> Pasi që Slovenia nuk ka ndonjë përfaqësues në Task Forcën NALAS, ajo nuk është e përfshirë në studimin krahasimor të nivelit lokal. Indikatorët e siguar në nivel shtetëror për Sloveninë janë gjetur në raportet referuese dhe infomatat e siguruar nga autoritetet Slovene.

<sup>3</sup> “Ky përcaktim bëhet pa ndonjë paragjykim ndaj pozicioneve për statusin dhe është në linjë me UNSC 1244 dhe Opinionin e GjND-së për deklarimin e pavarësisë së Kosovës.”

Studimi është realizuar me pjesëmarrje aktive dhe mbështetje të siguruar nga anëtarët e Task Forcës NALAS për menaxhimin e mbeturinave të ngurta dhe ujërave si dhe NALAS menaxherët e njohurive nga Asociacionet e pushtetit lokal të shteteve përkatëse.

Me qëllim të mundësimin të studimit krahasimor të performancës, krahasimit rajonal dhe monitorimit të zhvillimeve gjatë kohës, janë identifikuar<sup>4</sup> një grup i indikatorëve për menaxhim të integruar të qëndrueshëm të mbeturinave në nivelin shtetëror dhe komunal.

**Tabela 2:** Lista e indikatorëve në nivel shtetëror dhe lokal

INDIKATORËT E NIVELIT SHTETËROR	INDIKATORËT E NIVELIT LOKAL
<b>Indikator nr.1:</b> Popullsia në total	<b>Indikator nr.1:</b> Numri i popullsisë
<b>Indikator nr.2:</b> Të ardhurat në nivel shtetëror	<b>Indikator nr.2:</b> Raporti Urban/rural
<b>Indikator nr.3:</b> Gjenerimi i mbeturinave të ngurta komunale për kokë banori	<b>Indikator nr.3:</b> Popullsia e zonës urbane
<b>Indikator nr.4:</b> Indikator i trajtimit të mbeturinave	<b>Indikator nr.4:</b> Popullsia e zonës rurale
<b>Indikator nr.5:</b> Përqindja e riciklimit	<b>Indikator nr.5:</b> Gjenerimi i MNK për kokë banori
	<b>Indikator nr.6:</b> Përbërja e mbeturinave
	<b>Indikator nr.7:</b> Popullsia e mbuluar nga shërbimi i grumbullimit të MNK
	<b>Indikator nr.8:</b> Popullsia e mbuluar nga shërbimi i grumbullimit të MNK në zonat urbane
	<b>Indikator nr.9:</b> Popullsia e mbuluar nga shërbimi i grumbullimit të MNK në zona rurale
	<b>Indikator nr.10:</b> Popullsia e mbuluar nga shërbimi i paketimit të mbeturinave
	<b>Indikator nr.11:</b> Përqindja e riciklimit

<sup>4</sup> Në procesin e identifikimit të indikatorëve, janë marrë parasysh referencat në vijim: D. Willson për të gjithë indikatorët e studimit krahasues për menaxhim të integruar dhe të qëndrueshëm të mbeturinave, Pikët vlerësuese të UNEP për MMN të integruar, FOFAS/analizat e studimit krahasimor dhe prioritetet e politikave në Irlandë, BALKWASTE/Studim për zhvillimin e indikatorëve.

Indikatorët e selektuar i kombinojnë të dhënat e mbeturinave (sasinë dhe përbërjen) dhe nivelin e ofrimit të shërbimit (grumbullimin, trajtimin, hedhjen dhe riciklimin) që mundëson krahasimin në nivel rajonal.

Përveç emrit të indikatorit, njësisë matëse, arsyetimit të tij, mënyrës së kalkulimit dhe metodës së matjes, është përpiluar definicioni për secilin indikator (Tabela 3).

Tabela 3: Definicioni i indikatorëve të nivelit lokal

INDIKATORI	DEFINICIONI
<b>Përqindja urbane/rurale</b>	Përqindja e sipërfaqes urbane dhe /ose rurale (%) në raport me totalin e sipërfaqes së komunitetit lokal. Komuniteti përcaktohet si rural nëse densiteti i popullatës është nën 150 banorë për km katrorë (OECD <sup>5</sup> ).
<b>Gjenerimi i MNK për kokë banori</b>	Indikator i përfaqëson gjenerimin e mbeturinave komunale të shprehura në kg për person. Mbeturinat komunale i referohen mbeturinave të grumbulluara nga ose në emër të komunave. Pjesa kryesore rezulton nga amvisëritë, mirëpo mbeturinat e kompanive komerciale dhe tregtare, zyra, institucioneve dhe bizneseve të vogla janë gjithashtu të përfshira.
<b>Përbërja e mbeturinave</b>	Përqindja e komponentëve specifik të MNK (%) (xham, metal, material organik, letër, plastikë etj)
<b>Popullsia e mbuluar nga shërbimi i grumbullimit të MNK</b>	Përqindja e popullsisë së mbuluar me sistemin e grumbullimit (%). Këtu hyjnë amvisëritë e mbuluara nga shërbimi i grumbullimit derë më derë dhe amvisërive të mbuluara nga sistemi i grumbullimit me kontejner.
<b>Popullsia e mbuluar me shërbimin e grumbullimit të MNK në zona urbane/rurale</b>	Përqindja e popullsisë së mbuluar me sistemin e grumbullimit në zona urbane/ rurale (%). Këtu hyjnë amvisëritë e mbuluara me shërbimin e grumbullimit derë më derë dhe ato që mbulohen me sistemin e grumbullimit me kontejnerë.
<b>Popullsia e mbuluar me shërbimin e paketimit të mbeturinave</b>	Përqindja e popullsisë sëmbuluar nga sistemi i paketimit të mbeturinave (%).  Këto të dhëna janë të disponueshme ose në kompaninë e shërbimeve komunale ose në komunitetin lokal. Në shumë shtete është e vendosur rregullorja e cila përcakton standardet për numrin e banorëve për/ kontejner.  Nëse nuk ka një rregullore të tillë, duhet të merren parasysh kriteret vijuese: lokacioni i kontejnerit të veçantë duhet të jetë brenda 30 m (distançë horizontale) prej derës hyrëse të banesës individuale ose ndërtesës. Kalkulimi i numrit të shtëpive dhe banorëve të cilët jetojnë brenda distancës 30 m.
<b>Përqindja e riciklimit</b>	Vlera proporcionale (%) e cila reflekton proporcionin e materialeve të ricikluara ose të rikthyera nga mbeturinat e riciklueshme të disponueshme
<b>Trajtimi i mbeturinave</b>	Vlera proporcionale(%) e cila reflekton proporcionin e materialeve të trajtuara nga totali i mbeturinave të gjeneruara:  % e MNK të deponuara  % e MNK të hedhura në deponi të paligjshme të hapura  % e MNK nëtrajtim biologjik  % e MNK të trajtuara me TMB  % e MNK të trajtuara në termocentral  % e MNK të rikthyera përmes riciklimit

<sup>5</sup> Rajonet OECD në një shikim 2011

Gjithashtu janë përpiluar dy pyetësor (**Tabela 4**) dhe janë përdorur për të grumbulluar të dhënat e domosdoshme për secilin prej indikatorëve.

**Tabela 4:** Metoda hulumtuese e aplikuar për aspekte specifike hulumtuese

ASPEKTI I HULUMTIMIT	METOIDA E HULUMTIMIT
Shkalla, deri në të cilën, ligjet dhe/ose instrumentet tjera ligjore janë të vendosura dhe të zbatuara në nivel shtetëror dhe komunal për të mundësuar menaxhimin e mbeturinave të ngurta.	<p><b>Pyetësor për kornizën institucionale dhe ligjore për MMN</b></p> <p>Pyetësori është fokusuar mirëpo jo edhe kufizuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▲ Përgjegjësitë institucionale për MMN dhe grumbullim të të dhënave dhe raportim për indikatorët e MMN,</li> <li>▲ Korniza ligjore e cila e rregullon MMN,</li> <li>▲ Grumbullimi i të dhënave dhe raportimi në nivel shtetëror dhe të BE-së (raportimi në EEA).</li> </ul> <p>Të dhënat e domosdoshme për Pyetësorin janë grumbulluar nga anëtarët e TF NALAS për MMNU përmes konsultimeve me autoritetet shtetërore duke përdorur strukturat e Asociacioneve të pushtetit lokal.</p>
Studimi krahasimor i performancës së pilot komunave dhe analizave krahasimore të statusit aktual të menaxhimit të mbeturinave të ngurta komunale.	<p><b>Pyetësori për indikatorët e menaxhimit të mbeturinave të ngurta</b></p> <p>Pyetësori është fokusuar në të dyja nivelet, atë lokal dhe shtetëror, duke përfshirë dy kategori të indikatorëve: indikatorët e nivelit lokal dhe shtetëror.</p> <p>Anëtarët e Task Forcës NALAS kanë kontaktuar autoritetet shtetërore dhe lokale me qëllim të grumbullimit të të dhënave për kalkulim të indikatorëve.</p>

# Pasqyrë e përgjithshme e qeverive lokale në Evropën juglindore<sup>6</sup>

2

**Tabela 5** prezanton numrin dhe llojin e qeverive nën-sovrane ku operojnë anëtarët e NALAS-it të përfshirë në studimin krahasimor.

**Bosnja dhe Hercegovina (BH)** ka katër nivele të qeverisë. Shteti i BH-së; i) dy entitete, Republikën Srpska (RS të BH)

dhe Federatën e Bosnje dhe Hercegovinës (FBH të BH) si dhe ii) Qarkun Brcko; iii) kantonet nëFBH (BH); dhe iv) komunat në të dyja entitetet. NëFBH (BH), kantonet sigurojnë pjesën më të madhe të shërbimeve publike dhe entiteti qeveritar është relativisht i vogël.

**Tabela 5:** Nivelet, llojet dhe numrat e qeverive nën-sovrane, NALAS 2015<sup>7</sup>

ANËTARËT NALAS	Nivelet e Qeverisë Nën-sovrane	LLOJET E QEVERISE NËN-SOVRANE	# të rradhës së parë
1. Shqipëria AAM	2	Okruzi; opçine	61
2. Bosne dhe Hercegovinë	3	Entiteti; kantoni; opçine	143
FBH SOGFBH	2	Kantoni; opçine (mjesne zajednice)	80
RS ALVRS	1	Opçine (mjesne zajednice)	63
3. Bullgaria NAMRB	1	Opçine/komune (mjesne zajednice)	265
4. Kosova AKM	1	Opçine (mjesne zajednice)	38
5. Makedonija ZELS	1	Opçine (mjesne zajednice)	81
6. Moldavia CALM	2	Autonomna pokrajina	898
		Rejoni/regjije;	
		Opçine/komune	
7. Mali i Zi UoM	1	Opçine	21
8. Rumania FALR, ACoR	2	Okruzi; opçine/komune	3181
9. Serbia STCM	2	Autonome pokrajine; opçine (mjesne zajednice)	145
10. Turqia MMU	4	Specijalne pokrajinske uprave; gradske opçine; okružne opçine; komune	2854

<sup>6</sup> Të dhënat e prezantuara në Kapitullin 2 „ Pasqyrë e përgjithshme e pushteve lokale në Evropën Juglindore „ janë prezantuar dhe elaboruar në Raportin mbi Indikatorët e decentralizimit fiskal për Evropën Juglindore, NALAS 2006-2014.

<sup>7</sup> Raporti mbi indikatorët e decentralizimit fiskal për Evropën Juglindore, NALAS 2015

**Shqipëria** ka nivele të qarqeve me një rol shumë të kufizuar. **Moldavia** i ka dy nivele të qeverisë nën-sovrane, rajonet dhe komunat (si dhe Provincën Autonome Gaguzia). Udhëheqësit e rajonit janë të zgjedhur në mënyrë indirekte nga këshillat e rajonit dhe operojnë nën influencë të fuqishme qendrore. Ato gjithashtu ushtrojnë kontroll të madh mbi buxhetet e komunave. Kjo e turbullon dallimin ndërmjet qeverisë së rendit të parë dhe të dytë në Moldavi e poashtu edhe dallimin ndërmjet qeverive lokale dhe territoreve të shtetit. **Rumania** i ka dy nivele të qeverisë nën-sovrane, komunat dhe qytetet në njërën anë dhe qarqet në anën tjetër. **Serbia** i ka dy nivele të qeverisjes nën-sovrane, Provincën autonome të Vojvodinës dhe komunat. **Turqia** i ka katër nivele të qeverisë nën-sovrane. Tri prej tyre komuna, komuna qarku dhe komuna metropolitane- mund të konsiderohen si rendi i parë i qeverisë lokale. Mirëpo ato i kanë të drejtat dhe përgjegjësitë e ndryshme. Turqia gjithashtu i ka


51 Administrata Provinciale të Veçanta (APV) të zgjedhura në bazë të parimit të demokracisë. Ato funksionojnë në territore të nivelit shtetëror në pjesën më të madhe të rajoneve të Turqisë dhe ofrojnë disa shërbime publike sidomos në zona rurale. Në vendet ku ka komuna metropolitane nuk ka APV. Turqia gjithashtu i ka 30 komuna metropolitane.

Maqedonia, Mali i Zi, Kosova dhe Bullgaria kanë të vendosur sistemin e një rendi të vetëm të qeverisë lokale.

Tekqeveritë lokale të rendit të parë, në Evropën juglindore ka variacione të konsiderueshme të madhësisë mesatare. Moldavia i ka qeveritë më të vogla lokale të rendit të parë. Mesatarja e tyre është më e vogël se 4,000 banorë. Komunat në Rumani janë gjithashtu, relativisht të vogla, me mesatare nën 10,000 banorë (Diagrami 1).

Diagrami 1


Popullsia mesatare e Pushtetit Lokal të rendit të parë, raport mbi indikatorët e decentralizimit fiskal për Evropën Juglindore, NALAS 2006-2014.



Mirëpo si tërësi, madhësia mesatare e qeverive lokale në rajon është më e madhe sesa mesatarja për BE si tërësi. BeH, Bullgaria, Maqedonia, Mali i zi, Shqipëria, Serbia, Turqia dhe Kosova kanë komunat me popullsinë mesatare më të

madhe se 20,000. Një arsye për madhësinë relativisht të madhe të komunave në këto shtete është përqindja e lartë e njerëzve të cilët jetojnë në kryeqytete (**Diagrami 2**).

**Diagrami 2** Përqindja e popullsisë që jeton në kryeqytet, NALAS 2015







# Rishikimi i menaxhimit të mbeturinave të ngurta në nivel shtetëror

3



### 3.1 Shqipëria

Ministria e Mjedisit, Pylltarisë dhe Administrimit të Ujërave ka përgjegjësinë për përpilim të politikave dhe legjislacionit mbi menaxhimin e mbeturinave, bazuar në Ligjin nr. 10463/2011 “mbi menaxhimin e integruar të mbeturinave” dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 945/2013 “që përcakton përgjegjësinë shtetërore të Ministrisë së Mjedisit”. Autoritetet tjera bashkëpunuese në këtë fushë janë Ministria e punëve publike, transportit dhe telekomunikimit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Ekonomisë, tregtisë dhe energjisë dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Inspektimi dhe kontrolli janë nën kompetenca të Inspektoratit shtetëror të Mjedisit, Pylltarisë dhe Ujërave bazuar në VKM nr. 47/2014.

Agjencia Shtetërore e Mjedisit është përgjegjëse për sistemin informativ të Menaxhimit të Mbeturinave të Ngurta Komunale, grumbullimin e të dhënave, statistikave të mbeturinave dhe raportimit (VKM nr. 46 i datës 29.01.2014, VKM nr.687 i datës 29.07.2015). Nivelet tjera të përfshira në grumbullimin e të dhënave janë:

1. Komunat
2. Rajonet (Qarqet)
3. Ministrinë e linjës (Ministria e Bujqësisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Infrastrukturës/ transportit dhe Ministria përgjegjëse për industri)

Menaxhimi i mbeturinave të ngurta komunale në Shqipëri është në nivel të ulët mirëpo ka pasur përmirësim të situatës përmes zbatimit të Strategjisë nacionale për mbeturina dhe Planit nacional për menaxhim të mbeturinave 2010-2025.<sup>8</sup> Strategjia nacionale për mbeturina përcakton caqet e riciklimit / kompostimit në 25% të MNK deri me 2015 dhe 2020, synon rritjen e riciklimit/ kompostimit në 55% të MNK të gjeneruara.

Sipas shifrave të siguruara nga TFM NALAS nga Shqipëria (Tabela 6), mbeturinat e rikthyera nga riciklimi arrijnë në 10%.

Mirëpo, pjesa më e madhe hedhet në deponi, që për fat të keq arrin rreth 60% në deponi të të paligjshme të hapura.

<sup>8</sup> Menaxhimi i mbeturinave komunale në Shqipëri, EEA, përgatitur nga Arta Kodra, Agjencia e Mjedisit dhe Pylltarisë, NRP për Mbeturina,, Shqipëri dhe Leonidas Milios, ETC/SCP nëntor 2013

Tabela 6: Nacionalni indikator i o otpadu, Albanija

Numri i indikatorit	Indikator	Njësia	Shqipëri	Burimi i të dhënave
1	Totali i popullsisë	Numri	2,893.005	<a href="http://www.instat.gov.al/">http://www.instat.gov.al/</a>
2	Të ardhurat në nivel shtetëror	\$	4.564,4	<a href="http://data.worldbank.org/">http://data.worldbank.org/</a>
3	Gjenerimi i MNK për kokë banori	kg për ditë	0,6	Strategjia nacionale për MMN
4a	MNK të deponuara	%	30	<a href="http://www.mjedisi.gov.al">www.mjedisi.gov.al</a> Ministria e Mjedisit
4b	MMN në deponi të hapura të paligjshme	%	60	Ministria e Mjedisit
4c	Mbeturinat e rikthyera përmes riciklimit	%	10	Ministria e Mjedisit
4d	Trajtimi biologjik i MNK	%	0	Plani strategjik i qytetit
4e	MNK të trajtuara me TMB	%	0	
4f	MNK me trajtim termik	%	0	
5	Përqindja e riciklimit	%	33	Strategjia nacionale e MNK

### 3.2 Bosnja dhe Hercegovina

Menaxhimi i mbeturinave të ngurta komunale në Bosnje dhe Hercegovinë po ballafaqohet ende me probleme të shumta për sa i përket grumbullimit dhe trajtimit të mbeturinave. Megjithatë, ka pasur përmirësim të vogël të situatës përmes zbatimit të programit të dytë të Bankës Botërore për menaxhimin e mbeturinave të ngurta i cili ka filluar në 2008. Sipas Raportit<sup>9</sup> të fundit të BB (tetor 2015) Projekti ka pasur progres pozitiv gjatë majit të kaluar 2015. Megjithatë, progresi i përgjithshëm i zbatimit të projektit vazhdon të mbetet prapa në arritjen e caqeve me disbursimin e ngadalësuar dhe vetëm 44% të disbursuara para përmbyljes së projektit. Andaj, vlerësimi i progresit të përgjithshëm të zbatimit mbetet mesatarisht i pakënaqshëm.

Zhvillimi dhe zbatimi i politikës shtetërore të menaxhimit të mbeturinave nuk bëhet në nivel nacional por në nivel të entitetit dhe nivelin e Qarkut Brčko. Institucionet përgjegjëse janë Ministria Federale e Mjedisit dhe Turizmit, Ministria e Planifikimit Fizik dhe Injinerisë Civile dhe Ekologjisë e Republikës Srpska (më tej referuar si “Ministritë e entitetit për mjedis”) dhe Departamentin e planifikimit hapësinor dhe çështje pronësore të Qarkut Brčko. Kjo është rregulluar me ligjet e entitetit për menaxhimin e mbeturinave (Gazeta Zyrtare e RS 111/13, Gazeta Zyrtare e BHF 33/03, 72/09 dhe Gazeta Zyrtare e DB 72/09, 25/04, 1/05, 19/07, 2/08 dhe 9/09).

Grumbullimi i të dhënave për MNK, në përgjithësi nuk është mirë i strukturuar në vend. Janë disa nivele të grumbullimit të të dhënave që nuk janë të ndërlidhura e as të përdorura sistematikisht për qëllime të raportimit. Sipas Ligjit mbi Mbeturinat, të Republikës Srpska, autoriteti kompetent për grumbullimin e të dhënave të menaxhimit të mbeturinave dhe regjistrin për të dhënat e mbeturinave është Fondi për

<sup>9</sup> Raport mbi statusin e zbatimit dhe rezultatet, Banka Botërore, Menaxhimi i mbeturinave të ngurta 2 (P107998), tetor 2015

mbrojtje mjedisore dhe efikasitet të energjisë së RS. Rregullorja mbi metodologjinë e grumbullimit të të dhënave për mbeturina dhe regjistrin e të dhënave për mbeturina ishte adaptuar rishtazi (Gazeta Zyrtare e RS nr. 71/15). Ligjet federale dhe ato të Qarkut Brčko për menaxhimin e mbeturinave nuk i rregullojnë as grumbullimin e të dhënave për mbeturinat as regjistrin e të dhënave për mbeturina. Sistemi informativ i mbeturinave nuk rregullohet nga asnjëri prej tyre.

Fondi Federal për Mjedis dhe Fondi për Mjedis i Republikës Srpska po i grumbullojnë të dhënat nga kantonet, komunat, ndërmarrjet komunale publike dhe private dhe deponitë rreth sistemit të menaxhimit të mbeturinave të ngurta duke përfshirë edhe të dhënat për gjenerimin e mbeturinave dhe llojet e tyre. Këto të dhëna përdoren për qëllime të të kuptuarit më të mirë të situatës së menaxhimit të mbeturinave në të dyja entitetet. Agjencitë statistikore të entitetit i grumbullojnë të dhënat për mbeturinat e ngurta të grum-

bulluara dhe të hedhura, për qëllime statistikore.

Inspektimi dhe kontrolli realizohen në disa nivele administrative në FBH, RS dhe DB.Ne Federatën e BH, inspektimi realizohet në të dyja nivelet, atë federal dhe kantonale, nga ana e Drejtorisë Federale për Çështje Inspektimi dhe Drejtoritë Kantonale për Çështje Inspektimi. Në Republikën Srpska, inspektimi bëhet në të dyja nivelet, atë republikan dhe komunal, nga ana e Drejtorisë për Çështje Inspektimi të Republikës Srpska dhe policia komunale. Në qarkun Brčko, inspektimi bëhet në nivel të qarkut nga Departamenti i inspektimit. Të gjithë këta trupa administrativ kanë inspektor për çështje mjedisore që merren me çështje të menaxhimit të mbeturinave.

Grumbullimi dhe shërbimet e mbeturinave komunale organizohen në nivel komunal. Vetëm menaxhimi i mbeturinave në Kantonin e Sarajevës është organizuar në nivel kantonale.

**Tabela 7:** Indikatorët shtetëror të mbeturinave, Bosnje dhe Hercegovinë

Numri i indikatorit	Indikatorit	Njësia	Bosne dhe Hercegovinë	Burimi i të dhënave
1	Totali i popullsisë	Numri	3,827.343	Agjencia për statistika B&H
2	Të ardhurat në nivel shtetëror	\$	4.780	Agjencia për statistika B&H
3	Gjenerimi i MNK për kokë banori	kg për ditë	0,8	Agjencia për statistika B&H
4a	MMK të deponuara	%	70,1	Agjencia për statistika B&H, Shifra e përmirësuar
4b	MNK në deponi të hapura të paligjshme	%	24,3	E kalkuluar
4c	Mbeturinat e rikthyera përmes riciklimit	%	5,3	Kalkuluar në bazë të të dhënave të siguruar nga Agjencia për Statistika B&H, Lëshimi i parë: Mjedis, Transporti publik dhe Hedhja e Mbeturinave Komunale, nr.1, Viti VI 20.11.2015
4d	Trajtimi biologjik i MNK	%	0,0	-
4e	MNK të trajtuara në TMB	%	0,3	Kalkuluar në bazë të kapaciteteve të fabrikës
4f	MNK me trajtim termik	%	0,0	-
5	Përqindja e riciklimit	%	14	Kalkuluar në bazë të indikatorëve 3, 4 c dhe supozohet se 25% të totalit të mbeturinave janë të riciklueshme

Mbeturinat e rikthyera me riciklim janë shumë nën cakun prej 20% për riciklimin e mbeturinave komunale, të përcaktuar në Strategjinë Federale për Mjedis. Pjesa më e madhe e mbeturinave hidhet në deponi, për fat të keq 25% cca hidhet në deponi të hapura të paligjshme. Një pjesë e vogël trajtohet nëqendra të Trajtimit Mekanik Biologjik të instaluarara nëkomunat Tuzla dhe Konjic.

### 3.3 Bullgaria

Bullgaria është në proces të krijimit të sistemit të 55 qendrave regjionale për trajtim të mbeturinave të amvisërive. Barriera më e madhe ndaj ndryshimeve është natyra e pazhvilluar e objekteve aktuale të trajtimit të mbeturinave. Grumbullimi i ndarë i rrjedhave të mbeturinave është ende në faza të hershme. Pa marrë parasysh këtë barrierë, riciklimi konsiderohet të jetë top prioritet për sa i përket investimit të rritur<sup>10</sup>.

Ministria e Mjedisit dhe Ujërave (MMU) është përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e politikës nacionale për menaxhim të mbeturinave, duke përfshirë përpilimin dhe zbatimin e legjislacionit, strategjitë, programet si dhe rregullimin e aktiviteteve në të dyja sektorët, publike dhe private. Ministria i zhvillon disa prej këtyre aktiviteteve përmes Agjencisë Ekzekutive Mjedisore dhe rrjetit të autoriteteve kompetente regjionale, Inspektorateve regjionale të Mjedisit dhe Ujërave të cilat kontrollojnë zbatimin e legjislacionit për menaxhimin e mbeturinave.

Ligji Bullgar për menaxhimin e mbeturinave, i miratuar në 2003 përcakton përgjegjësitë dhe obligimet e autoriteteve shtetërore dhe lokale për sa i përket organizimit, autorizimit, financimit, mbikëqyrjes dhe kontrollit të aktiviteteve të menaxhimit të mbeturinave. Ligji për menaxhimin e mbeturinave, i miratuar në korrik 2012, ka paraqitur Direktivën kornizë të BE-së për mbeturina në legjislacionin Bullgar, duke rregulluar kështu obligimet e komunave dhe gjendjen e riciklimit të mbeturinave.

Në përputhje me Ligjin për menaxhimin e mbeturinave, «SG», nr. 86/30.09/2003 dhe Urdhëresën nr. 9/28.09/2004 mbi procedurat dhe mënyrat e dorëzimit të informatave mbi aktivitetet e lidhura me mbeturina dhe procedurën e mbajtjes së regjistrit publik për lejet e lëshuara, dokumentet e regjistrimit dhe deponitë e aktivitetet e mbyllura, grumbullimi i të dhënave për indikatorët e MNK dhe Sistemin informativ të MNK janë përgjegjësi e ExEA, përdërisa statistikatat për mbeturina janë përgjegjësi e Institutit Shtetëror për statistika. ExEA, në bashkëpunim me NSI përgatitë raportin nacional për MMN. Komunat janë përgjegjëse për grumbullim të të dhënave për mbeturina dhe i dorëzojnë ato në NSI. NSI grumbullon informata për numrin e deponive ku mbeturinat komunale grumbullohet nga sistemet për grumbullim të organizuar, e poashtu edhe informata për sasitë e gjeneruara, të grumbulluara dhe të deponuara, mbeturinat komunale dhe ndërtimore, madhësinë dhe kapacitetin e deponive, numrin e vendbanimeve të shërbyera dhe përqindjen e popullsisë. Sasia e mbeturinave të gjeneruara komunale raportohet në baza vjetore në Eurostat.

Të dhënat e përdorura për 2014 janë siguruar nga anketa e rregullt statistikore për mbeturinat komunale dhe sistemi informativ shtetëror për mbeturina i Agjencisë Ekzekutive Mjedisore.

Sipas Institutit Nacional për statistika, në 2014<sup>11</sup>, totali i mbeturinave të gjeneruara ishte llogaritur të jetë 3,193 mijë tonë. Sipas statistikave zyrtare, 2895 mijë tonë të mbeturinave komunale janë deponuar në 2014. Mbeturinat të cilat janë transferuar drejtpërdrejtë për riciklim në 2014 kanë qenë 298 mijë ton. Mbeturinat e dërguara në objektet për trajtim të dytë ishin rreth 1 598 mijë ton, cca 639 ton janë djegur. Mbeturinat e paketuara të gjeneruara kanë qenë 380,682 ton.

Për qëllime të përgatitjes së këtij raporti mbi studimin krahasimor, indikatorët shtetëror janë kalkuluar duke u bazuar në shifrat e siguruar në statistika zyrtare. Në pjesën më të mad-

<sup>10</sup> Menaxhimi i mbeturinave në Evropën Qendrore dhe Lindore, C.M.S. 2013

<sup>11</sup> Statistikat mjedisore – të dhënat vjetore për 2014, Komunikata për shtyp

he të kalkulimeve, shifrat kryesore kanë shprehur mbeturinat e gjeneruara dhe kanë qenë 3,193 mijë ton siç janë raportuar zyrtarisht. Gjenerimi i MN për kokë banori ja qenë 442 kilogram të mbeturinave komunale tëgrumbulluara për kokë banori për 2014. Me të njëjtin numër të popullsisë, kjo jep 1.2 kg mbeturina të grumbulluara për kokë banori. Sasia e mbeturinave të grumbulluara komunale vlerësohet përmes matjeve direkte dhe në rast të mungesës së pajisjeve matëse- në bazë të dokumenteve të transportit.

Edhe pse jo të gjithë indikatorët janë të disponueshëm, është më se e qartë se ka pasur progres në rikthimin e mbeturinave. Me asistencën e ICMA (Asociacioni ndërkombëtar për menaxhim të qytetit/ qarkut), 19 komuna kanë paraqitur pilot programin e kompostimit duke hapur kështu një ose më tepër vende kompostimi. Komposti i gjeneruar përdoret kryesisht nëblegtori.<sup>12</sup>

**Tabela 8:** Indikatorët shtetëror të mbeturinave, Bullgari

Numri i indikatorit	Indikator	Njësia	Bullgari	Burimi i të dhënave
1	Totali i popullsisë	Numri	7,191.325	Instituti shtetëror i statistikave(2014)
2	Të ardhurat në nivel shtetëror	\$	5.900	
3	Gjenerimi i MNK për kokë banori	kg për ditë	1,2	Instituti shtetëror i statistikave, të dhënat vjetore për 2014, Komunikata për shtyp
4a	MMK të deponuara	%	90,7	Instituti shtetëror i statistikave, të dhënat vjetore për 2014, Komunikata për shtyp
4b	MNK në deponi të hapura të paligjshme	%	2,0	Instituti shtetëror për statistika, të dhënat vjetore për 2014, Komunikata për shtyp
4c	Mbeturinat e rikthyera përmes riciklimit	%	7,3	Instituti shtetëror për statistika, të dhënat vjetore për 2014, Komunikata për shtyp
4d	Trajtimi biologjik i MNK	%	n/a	-
4e	MNK të trajtuara në TMB	%	n/a	-
4f	MNK me trajtim termik	%	n/a	-
5	Përqindja e riciklimit	%	10	Kalkuluar në bazë të statistikave zyrtare

<sup>12</sup> Kompostimi në Bullgari për reduktim të mbeturinave, ICMA International

<sup>13</sup> Menaxhimi i mbeturinave në Evropën Qendrore dhe Lindore , C.M.S. 2013

### 3.4 Kosova

Republika e Kosovës po kalon në një fazë intenzive të dizajnit dhe ndryshimit të legjislacionit për menaxhimin e mbeturinave bazuar në udhëzimet dhe rregulloret e BE-së. Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e mbeturinave është miratuar në 2012 për një periudhë 10 vjeçare. Baza ligjore për Strategjinë është Ligji për mbeturinat nr. 04/L-060. Mandati i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor përcaktohet nga Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/5 dhe 2005/15 dhe është përgjegjëse për zhvillim të politikave, lëshim të lejeve, koordinim dhe mbikëqyrje dhe zbatim të konventave ndërkombëtare. Me qëllim të arritjes së një gjëje të tillë Ministria i ka krijuar 7 departamente, 2 institute dhe Agjencinë për mbrojtje të mjedisit. Agjencia e Kosovës për mbrojtje të mjedisit i ka tri divizione:

- ▲ Drejtorinë për sistemin informativ mjedisor,
- ▲ Drejtorinë për monitorim mjedisor dhe
- ▲ Drejtorinë për dizajnim të raporteve, planeve dhe programeve mjedisore

Agjencia Kosovare për Mbrojtje të Mjedisit ishte krijuar në bazë të Ligjit për mbrojtje të mjedisit nr. 50/2009. Drejtoria e Mjedisit, sektori për ajër, zhurmë dhe mbeturina, që është pjesë e Agjencisë së Kosovës për mbrojtje të mjedisit është përgjegjëse për zhvillimin e bazës së të dhënave dhe sistemit informativ për menaxhim të mbeturinave dhe raportim për situatën e menaxhimit të mbeturinave. Qeveritë komunale janë përgjegjëse për përpilimin e planeve lokale për menaxhimin e mbeturinave, përgatitjen e raporteve vjetore për menaxhim të mbeturinave të dorëzuar në Ministri dhe rregullimin, zbatimin dhe organizimin e menaxhimit të mbeturinave në territorin e tyre.

**Tabela 9:** Indikatorët shtetëror të mbeturinave , Kosovë

Numri i indikatorit	Indikator	Njësia	Kosovë	Burimi i të dhënave
1	Popullsia në total	Numër	1,800.000	Zyra e statistikave të Kosovës
2	Të ardhurat në nivel shtetëror	\$	4.000	Banka Botërore 2014
3	Gjenerimi i MNK për kokë banori	Kg për ditë	0,9	Zyra e statistikave të Kosovës
4a	MNK të deponuara	%	90	Ministria e mjedisit
4b	MNK në deponi të hapura të paligjshme	%	0	-
4c	Mbeturinat e rikthyera përmes riciklimit	%	9	Ministria e mjedisit
4d	Trajtimi biologjik i MNK	%	1	Ministria e Mjedisit
4e	MNK të trajtuara në TMB	%	0	-
4f	MNK me trajtim termik	%	0	-
5	Përqindja e riciklimit	%	n/p	.

Mbeturinat e rikthyera përmes riciklimit janë 9% dhe pjesa më e madhe e mbeturinave pra 90% është e hedhur në deponi. Megjithatë, hedhja ilegale nuk është raportuar zyrtarisht. Organizata “Open Data Kosovo” dhe UNDP/SDC (nën projektin SAEK) ka paraqitur platformën e vizuelizimit të të dhënave mbi deponitë e paligjshme. Iniciativa është rezultat i të dhënave të grumbulluara nga 40 vullnetarë të rinj të komunitetit lokal të Gjakovës (në Kosovë) të cilët i kanë raportuar totalin prej 686 vendeve të paligjshme për hedhje të mbeturinave.<sup>14</sup>

### 3.5 Maqedonia

Menaxhimi i mbeturinave në Maqedoni rishtazi është pranuar të jetë çështje brengosëse dhe janë bërë përpjekje me qëllim të zbutjes së ndikimit të mbeturinave në mjedis dhe shoqëri. Në vitet e mëparshme, menaxhimi i mbeturinave është mbështetur ekskluzivisht në hedhjen dhe deponimin e MNK.<sup>15</sup>

Ligji mbi menaxhimin e mbeturinave, që është miratuar në 2004, përbën një akt të rregullimit dhe siguron rregullat e përgjithshme të cilat aplikohen në çështjet kryesore të mbeturinave të rrezikshme dhe të parrezikshme dhe rrjedhat e veçanta të mbeturinave. Detyrat dhe përgjegjësitë në fushën e menaxhimit të mbeturinave, në praktikë, janë të ndara në disa institucione të ndryshme të shtetit ku rol dominant luan Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Fizik dhe komunat. Autoritetet kompetente për inspektim dhe detyra tjera zbatuese është përgjithësisht Inspektimi shtetëror për mjedis dhe Këshilli i Inspektimeve si një organ i pavarur (në nivelin qendror). Autoritetet kompetente për inspektim në nivelin lokal janë departamentet komunale të inspektimit.

<sup>14</sup> <http://opendatakosovo.org/app/illegal-dumps/>

<sup>15</sup> Menaxhimi i mbeturinave komunale në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë 2013, Qendra e informatave mjedisore/ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Fizik të ish- Republikës Jugosllave të Maqedonisë në bashkëpunim me (ETC/SCP), menaxhuar nga Instituti burimor i Kopenhagës, në emër të Agjencisë Evropiane për Mjedisin (EEA).

Komunat janë përgjegjëse për organizimin e grumbullimit, transportit dhe hedhjes së mbeturinave komunale; përcaktimit të lokacionit të objekteve për menaxhim të mbeturinave, lëshimit të rregulloreve për menaxhim të mbeturinave ; financim dhe mbikëqyrje të mbylljes së deponive/ vendeve për hedhje plehrash dhe mbylljes së objekteve për menaxhim të mbeturinave.

Dokumentet kyçe të politikave për menaxhim të mbeturinave në nivel shtetëror janë Strategjia nacionale e menaxhimit të mbeturinave për periudhën 2008-2020 (Gazeta zyrtare nr. 39/08) dhe Plani nacional i menaxhimit të mbeturinave për periudhën 2009-2015 (Gazeta zyrtare nr. 77/09). Një prej objektivave kryesore strategjike të strategjisë MNK është vendosja e sistemit informativ për grumbullimin e të dhënave mbi burimet, natyrën, sasinë dhe të ardhmen e rrjedhave të mbeturinave si dhe për objektet për rikthim të materialit/ energjisë dhe hedhjes finale të mbeturinave kërkohet sigurimi i qasjes publike.<sup>16</sup> Qendra e Informatave Mjedisore e Maqedonisë është departament brenda Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Fizik. Funksioni kryesor i MMIM është sigurimi i informatave relevante, të përpunuara me korrektësi (të sistematizuara dhe të standardizuara), gjithëpërfshirëse, precize, transparente dhe lehtësisht të qasshme mbi situatën, cilësinë dhe trendet në të gjitha segmentet mjedisore (uji, ajri, zhurma, mbeturinat). Maqedonia ka bashkëpunuar me EEA që nga 1997. Ministria ka bashkëpunuar me ETC (ajri dhe ndryshimi klimatik, uji, diversiteti biologjik, menaxhimi i mbeturinave dhe burimet, përdorimi i tokës dhe informatat hapësinore, ITTAG) dhe ka përgatitur raporte vlerësimi dhe SOER.<sup>17</sup>

<sup>16</sup> Strategjia për menaxhim të mbeturinave e Republikës së Maqedonisë (2008–2020)

<sup>17</sup> Punëtorja për mjetet informative elektronike për mbështetjetë zbatimit të punëtorisë të Konventës Aarhus në SEE, Vendosija e sistemit informativ e-mjedisor, Svetlana Gjorgjeva, Qendra Maqedone e Informatave Mjedisore, nëntor 2010, Maqedoni



**Tabela 10:** Indikatorët shtetëror të mbeturinave, Maqedonia (2011)

Numri i indikatorit	Indikator	Njësia	Maqedonia	Burimi i të dhënave
1	Totali i popullsisë	Numër	2,107.000	Zyra e statistikave të Maqedonisë
2	Të ardhurat në nivel shtetëror	\$	4.838	World Bank 2014
3	Gjenerimi i MNK për kokë banori	kg për ditë	1,0	Raporti EEA
4a	MNK të deponuara	%	99,7	Raporti EEA
4b	MNK në deponi të hapura të paligjshme	%	0	Raporti EEA
4c	Mbeturinat e rikthyera me riciklim	%	0,3	Raporti EEA
4d	Trajtimi biologjik MNK	%	0	Raporti EEA
4e	MNK të trajtuara në TMB	%	0	Raporti EEA
4f	MNK nën trajtim termik	%	0	Raporti EEA
5	Përqindja e riciklimit	%	12	

Sipas raportit të EEA <sup>18</sup> mbi Menaxhimin e mbeturinave komunale në Republikën e Maqedonisë, metoda dominante në menaxhimin e mbeturinave komunale dhe të tjera të parrezikshme është hedhja e tyre në deponi të ligjshme që korrespondon me 99.74 % të sasisë totale të mbeturinave të ngurta të gjeneruara në 2012. Pjesa e mbetur 0.26 % e MNK janë ricikluar ose kompostuar. Në 2012, përqindja e paketimit të ricikluar ishte 12 % e totali të paketimit të vendosur në treg<sup>19</sup>. Hedhja e paligjshme e mbeturinave nuk është raportuar zyrtarisht, edhe pse janë regjistruar më tepër se 300 vende gjatë aksioneve të organizatës Let's do it Macedonia<sup>20</sup>.

### 3.6 Moldavia

Situata në sistemin e menaxhimit të mbeturinave të ngurta karakterizohet me ekzistencën e shërbimeve MMN në qytete dhe fshatra të mëdha, mungesë të pajisjeve për grumbullim dhe transportim të mbeturinave, sasi të rritur të mbeturinave, mungesë të kapaciteteve për hedhje të mbeturinave, mungesë të sistemit të organizuar të riciklimit për momentin dhe nivel të ulët të vetëdijesimit të publikut rreth menaxhimit të mbeturinave.<sup>21</sup>

Strategjia nacionale e MNK, e Republikës së Moldavisë (2013-2027) thërret rristrukturimin ligjor dhe institucional si dhe krijimin e një sistemi të integruar të rregullimit teknik dhe mjedisor në fushën e grumbullimit selektues të mbeturinave për riciklim, rikthim, hedhje të mbeturinave dhe ruajtje. Bazuar në këtë Strategji, Qeveria e Moldavisë merr përsipër zhvillimin e kornizës së re ligjore dhe institucionale për rregullimin e menaxhimit të mbeturinave nën legjisllacionin e BE-së që do të ishte ekonomikisht efikase dhe do të merite

<sup>18</sup> Menaxhimi i mbeturinave komunale në ish- Republikën Jugosllave të Maqedonisë, EEA 2013

<sup>19</sup> <http://www.eea.europa.eu/soer-2015/countries/the-former-yugoslav-republic-of-macedonia>

<sup>20</sup> <http://ajdemakedonija.mk/en/ëastemap>

<sup>21</sup> Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave të ngurta komunale në Republikën e Moldavisë, Osteuropaverein der deutschen Wirtschaft, shtator 2014

parasysh shëndetin e njeriut dhe mjedisin. Aktualisht, Ligji për mbeturinat shtëpiake dhe prodhimin e tyre, nr. 1347-XIII, 1997 rregullon MNK .

Sipas Strategjisë nacionale të MNK grumbullimi dhe përpunimi i informatës në lidhje me llojet dhe sasi të mbeturinave bëhet sipas standardeve të ish BS pa ndonjë adaptim ndaj kërkesave të Evropiane për klasifikim. Sistemi aktual i menaxhimit të mbeturinave vetëm pjesërisht reflekton situatën e menaxhimit të mbeturinave shtëpiake përdërisa informata për rrjedhat e mbeturinave specifike të rrezikshme sikurse vajrat, automjetet në fund të ciklit jetësor, gomat, akumulatorët dhe bateritë, mbeturinat elektrike dhe pajisjet elektronike si dhe mbeturinat e amvisërive është e paqëndrueshme. Edhe pse disa ndërmarje për përpunim të mbeturinave ekzistojnë në Republikën e Moldavisë informata për vëllimin e mbeturinave të ricikluara ende nuk është nën monitorim statistikor. Zyra shtetërore e statistikave në Moldavi është përgjegjëse për grumbullim të të dhënave dhe statistika.

Qeveritë lokale janë përgjegjëse për organizimin e grumbullimit të mbeturinave dhe sistemeve të hedhjes. Strategjia nacionale e MNK synon të vendosë menaxhimin e integruar të mbeturinave duke përcaktuar tetë rajone. Banka Evropiane për Investime do ta mbështesë projektin i cili do të fokusohet në zbatimin e projekteve të sektorit të mbeturinave të ngurta në tërë Moldavinë, duke mbështetur zbatimin e Strategjisë së Menaxhimit të Mbeturinave 2013 të Republikës së Moldavisë.

Sipas Strategjisë nacionale për menaxhim të mbeturinave të Moldavisë dhe kërkimeve të Bankës Ndërkombëtare, paralel me rritjen e nivelit të të ardhurave të popullatës rritet edhe përqindja e gjenerimit të mbeturinave për kokë banori që zakonisht është 0.3-0.4 kg/për kokë banori/ditë në zona rurale dhe 0.9 kg/për kokë banori/ditë ose më lartë në zona urbane. Aktualisht, metoda më e përhapur e trajtimit të mbeturinave të amvisërive është ruajtja e mbeturinave në tokë që është një prej burimeve kryesore të ndotjes së ujit dhe dheut.

**Tabela 11:** Indikatorët shtetëror të mbeturinave, Moldavia

Numri i indikatorit	Indikatori	Njësia	Moldavi	Burimi i të dhënave
1	Totali i popullsisë	Numër	3,559.500	Biroja statistikore e Moldavisë
2	Të ardhurat në nivel shtetëror	\$	4.753,55	Banka Botërore 2014
3	Gjenerimi i MNK për kokë banori	kg për ditë	0,65	Strategjia e menaxhimit të mbeturinave, 2013
4a	MNK të deponuara	%	0	
4b	MNK në deponi të hapura të paligjshme	%	100	Strategjia e menaxhimit të mbeturinave , 2013
4c	Mbeturinat e rikthyera me riciklim	%	0	
4d	Trajtimi biologjik i MNK	%	0	
4e	MNK të trajtuara në TMB	%	0	
4f	MNK të trajtuara në termocentral	%	0	
5	Përqindja e riciklimit	%	0	

### 3.7 Mali i Zi

Përmes miratimit të Ligjit të Veçantë mbi mbeturinat në 2011 (Gazeta Zyrtare e Malit të Zi 64/11) dhe grupit të akteve nënligjore (27 akte nënligjore të miratuara deri në 2013 dhe 4 më tepër mbesin sipas Ligjit), Parlamenti i Malit të Zi ka vendosur një kornizë solide ligjore për sistemin nacional të menaxhimit të mbeturinave. Pasi që Mali i Zi është shtet kandidat i BE-së ky grup i rregulloreve vazhdimisht amendamentohet përmes një procesi të vazhdueshëm të harmonizimit me Acquis-në e BE-së.

Korniza aktuale institucionale e menaxhimit të mbeturinave në Mal të Zi përcakton përgjegjësitë kryesore në fushën e menaxhimit të mbeturinave në nivelin qendror (Ministria e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Turizmit) dhe lokal (23 komuna) dhe përgjegjësitë specifike të deleguara tek Agjencitë, Ministrinë tjera dhe Inspektoratet Shtetërore (sipas mandatit të tyre).

Sipas Ligjit mbi Statistikat, Agjencia për Statistika e Malit të Zi, MONSTAT, është përgjegjëse për grumbullimin e të gjitha të dhënave të nevojshme për qëllime statistikore. Agjencia vendosë se cilat të dhëna do ti grumbullojë në programin vjetor të statistikave. Aktualisht, ende ka statistika të dyfishta për sa i përket çështjeve të mbeturinave, pasi që EPA poashtu po i grumbullon të dhënat dhe po i raporton ato tek Ministrinë dhe Qeverinë. Indikatorët e Menaxhimit të Mbeturinave janë gjetur në të dhënat e grumbulluara nga Agjencia. Plani aktual nacional i menaxhimit të mbeturinave i njeh disa barrierë drejt zbatimit të suksesshëm. Ato që lidhen me monitorimin dhe raportimin janë: i) regjistrimi i të dhënave të shërbimeve komunale është i mangët dhe skemat e raportimit janë të fragmentuara; ii) Grumbullimi i dyfishtë, madje edhe i trefishtë në nivel lokal krijon konfuzion; iii) Të dhënat jo-konsistente (krahasimi në burim –Librat vjetor). Ligji i mjedisit rregullon vendosjen e sistemit informativ mjedisor. Sistemi i menaxhimit të mbeturinave është një pjesë integrale e sistemit të informatave mjedisore.

**Tabela 12:** Indikatorët shtetëror të mbeturinave, Mali i Zi

Numri i indikatorit	Indikator	Njësia	Mali i zi	Burimi i të dhënave
1	Totali i popullsisë	Numër	620.029	MONSTAT
2	Të ardhurat në nivel shtetëror	\$	7.130	MONSTAT
3	Gjenerimi i MNK për kokë banori	kg për ditë	1,08	NWMP
4a	MNK të deponuara	%	86,6	NWMP
4b	MNK në deponi të hapura të paligjshme	%	11	NWMP
4c	Mbeturinat e rikthyera përmes riciklimit	%	0,8	NWMP
4d	Trajtimi biologjik i MNK	%	0	NWMP
4e	MNK të trajtuara në TMB	%	0	NWMP
4f	MNK me trajtim termik	%	0	NWMP
5	Përqindja e riciklimit	%	4,7	NWMP

\*NWMP- Plani nacional për menaxhimin e mbeturinave

Përqindja e riciklimit është shumë më e ulët se sa caku prej 50% të riciklimit të mbeturinave komunale të përcaktuar nga Strategjia nacionale e menaxhimit të mbeturinave për vitin 2020. Një cak tjetër prej 60% është zgjedhur në vitin 2025.

Pjesa më e madhe e mbeturinave është hedhur në deponi, mirëpo ende 11% janë të hedhura në deponi të hapura të paligjshme.

### 3.8 Rumunia

Strategjia e parë nacionale për menaxhimin e mbeturinave në Rumuni është zhvilluar për periudhën 2003-2013 pas transpozimit të legjislacionit të BE-së në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe sipas dispozitave të Urdhresës së Qeverisë për Emergjencë nr. 78/2000 mbi rezhimin e mbeturinave. Plani nacional për menaxhimin e mbeturinave ishte zhvilluar poashtu në 2004 me qëllim të ndërmarrjes së veprimeve të domosdoshme për arritjen e objektivave të Strategjisë. Me qëllim të rritjes së zbatimit efikas të Planit Nacional për menaxhim të mbeturinave, në vitin 2006 janë lëshuar Planet rajonale për menaxhim të mbeturinave për tetë rajonet Rumune.

Ministria e Mjedisit dhe Ndryshimit Klimatik është autoritet kompetent për koordinimin e zbatimit të Direktivës Kornizë për Mbeturina dhe legjislacionit rezultues Rumun. Ligji për kornizën rregullatorë të mbeturinave (Ligji 211/2011) ka hyrë në fuqi me 28 nëntor 2011 dhe ka transpozuar DFM në legjislacionin nacional.

Përgjegjësia për grumbullimin dhe menaxhimin e mbeturinave të ngurta komunale i takon komunave. Autoritetet lokale janë të involvuara në implikimet praktike të vendosjes së sistemeve për grumbullim, përpunim, ruajtje të ndarë etj si dhe koordinim të aktivitetëve në fushën e para grumbullimit dhe organizimit të riciklimit të mbeturinave.

Agjencia Rumune për mbrojtje të mjedisit është përgjegjëse për grumbullimin e të dhënave për mbeturina, raportim në nivel shtetëror dhe raportim në EEA. Kjo çështje është rregulluar me Ligjin 51/2006 për shërbimet publike komunale. Grumbullimi i të dhënave për indikatorët e MNK dhe statistikave për mbeturina rregullohet nga një numër ligjesh: i) Ligji 211/2011 për rregullimin e mbeturinave, ii) Ligji 51/2006 për shërbimet publike komunale, iii) Ligji 101/2006 për pastrimin e qytetit, iv) HG 856/2002 për menaxhimin e mbeturinave.

**Tabela 13:** Indikatorët shtetëror të mbeturinave, Rumunia

Numri i indikatorit	Indikator	Njësia	Rumunia	Burimi i të dhënave
1	Totali i popullsisë	Numër	19,550.000	Zyra e statistikave të Rumanisë
2	Niveli shtetëror i të hyrave	\$	6.195	Banka Botërore 2014
3	Gjenerimi i MNK për kokë banori	Kg për ditë	1,5	Zyra e statistikave të Rumanisë, 2011
4a	MNK të deponuara	%	85	Zyra e statistikave të Rumanisë, 2011
4b	MNK në deponi të hapura të paligjshme	%	5	Zyra e statistikave të Rumanisë, 2011
4c	Mbeturinat e rikthyera përmes riciklimit	%	7	Zyra e statistikave të Rumanisë, 2011
4d	Trajtimi biologjik i MNK	%	3	Zyra e statistikave të Rumanisë, 2011
4e	MNK e trajtuara në TMB	%	0	
4f	MNK me trajtim termik	%	0	
5	Përqindja e riciklimit	%	29	Kalkulimi i bazuar në përberjen e mbeturinave dhe 4c

Objektet ekzistuese të trajtimit biologjik trajtojnë kryesisht mbeturinat e gjelbërta prej parqeve dhe kopshteve dhe një pjesë të vogël të organikeve të amvisërive. Poashtu, njëfabrikë për kompostim në rajon 3 në jug dhe një tjetër në rajonin 2 në juglindje janë në ndërtim e sipër. Kapaciteti i fabrikës së kompostimit për pjesë organike të mbeturinave të ngurta në Piatra Neamt është 12,000 t/vit të pjesëve organike (biodegradueshme) me hapësirë të disponueshme për zgjerim të mundshëm në të ardhmen prej 5,000 t/vit. Kjo ndërlihet me pjesët organike të iodegradueshme të MNK.

### 3.9 Serbia

Sipas Raportit “ State of the Nation” 2012 të Asociacionit ndërkombëtar të mbeturinave të ngurta menaxhimi i mbeturinave në Serbi bazohet vetëm në grumbullimin dhe hedhjen e mbeturinave, jo strikt në deponi sanitare, po shpeshherë edhe në vende të vogla të hapura për hedhje plehrash. Me qëllim të ndryshimit të praktikës ekzistuese, caqet kryesore të menaxhimit të mbeturinave në Serbi janë rritja në selektimin dhe ndarjen e të riciklueshmeve sidomos e mbeturinave të paketimit dhe hedhja e mbetjeve në deponi (rajonale) sanitare<sup>22</sup>.

Ministria e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit është përgjegjëse për zhvillimin e politikës nacionale të mbeturinave. Ministria përgjegjëse për mjedis zakonisht i përpilon ligjet për mbeturina që dërgohen më pastaj në Parlament përmes Qeverisë për miratim. Strategjia e mbeturinave përpilohet nga Ministria përgjegjëse për mjedis dhe miratohet nga Qeveria. Ministri përgjegjës për mjedis miraton aktet nënligjore (rregulloret, format etj) përdërisa autoritetet lokale (Këshillat lokal i miratojnë urdhëresat lokale në përputhje me rrethanat. Zbatimi i ligjit ndahet në nivele qendrore, provinciale dhe lokale si dhe në inspektim dhe kontroll.

<sup>22</sup> ISWA, Raport State of the Nation, praktikat e deponimit dhe rregullorja e Serbisë 2012

Agjencia e Serbisë për mbrojtje mjedisore (SEPA) është përgjegjëse për grumbullimin e të dhënave për sasinë e mbeturinave dhe të riciklueshmeve, përpunimit të të dhënave dhe komunikimit e informimit të EEA. Të dhënat e përgjithshme për mbulimin e shërbimit grumbullohen dhe përpunohen nga Zyra Shtetërore e Statistikave. Sipas rregullores së Serbisë, janë 9 indikatorë të mbeturinave. Secili prej tyre është i ndatë në nën-indikatorë. Kërkimi në uebfaqen zyrtare të SEPA-së nuk tregon ndonjë rezultat. Grumbullimi i të dhënave për indikatorët e MNK rregullohet me një numër ligjesh dhe rregulloresh:

- ▲ Ligji mbi menaxhimin e mbeturinave (“Gazeta Zyrtare e RS”, nr. 36/09 dhe 88/10); Neni 75
- ▲ Ligji mbi paketimin dhe mbeturinat e paketimit (“Gazeta zyrtare” nr. 36/09);
- ▲ Ligji mbi ratifikimin e Konventës së Bazelit për Lëvizjet ndërkufitare të mbeturinave të rrezikshme dhe largimin e tyre (“Gazeta zyrtare e IRJ – Traktatet ndërkombëtare” nr. 2/99);
- ▲ Urdhëresa për metodologjinë e përgatitjes së regjistrimit shtetëror dhe lokal të burimeve të ndotjes si dhe metodologjinë për llojet, mënyrat dhe kushtet e grumbullimit të të dhënave (“gazeta zyrtare” nr. 91/10);
- ▲ Urdhëresa në formë të të dhënave ditore dhe raportimi vjetor për mbeturinat me udhëzime për përfundimin e tij (“gazeta zyrtare” nr. 95/10);
- ▲ Rregullimi i kategorive, testimi dhe klasifikimi i mbeturinave (“gazeta zyrtare e RS nr. 56/10);

Agjencia e Serbisë për mbrojtje të mjedisit grumbullon të dhëna për emetimet në ajër, emetimet në ujë dhe mbeturina. Të dhënat e grumbulluara hyjnë në bazën e të dhënave duke formuar kështu sistemin informativ mjedisor të Republikës së Serbisë. Sistemi informativ mjedisor, monitorimi dhe raportimi në nivel nacional janë rregulluar me Ligjin

që amendamenton Ligjin mbi mbrojtjen e mjedisit (“gazeta zyrtare”, nr. 72/2009); nenet 69,73 dhe 74. Zyra statistikore e RS raporton mbi gjenerimin e mbeturinave dhe popullatën e shërbyer. Megjithatë, shifrat janë të vjetruara dhe i referohen vitit 2008. Raportimi në EEA rregullohet me Ligjin për Ministrinë (“gazeta zyrtare e RS” nr. 44/2014, 14/2015, 54/2015) neni 5.

Serbia aktualisht riciklon 7% deri 8% të mbeturinave të saj komunale sikurse xhami, druri, letra, plastika dhe metali. Serbia ka 3582 deponi të identifikuara, 165 prej të cilave janë deponi komunale, 5 janë deponi sanitare dhe pjesa e mbetur janë vende të paligjshme për hedhje të plehrave<sup>23</sup>. Llogaritjet se 20% e mbeturinave të gjeneruara hedhen në deponi të paligjshme. Janë 5 deponi sanitare rajonale në proces të ndërtimit si dhe mbyllja dhe pastrimi dhe /ose rikultivimi i disa deponive komunale.

**Tabela 14:** Indikatorët shtetëror të mbeturinave, Serbia

Numri i indikatorit	Indikator	Njësia	Serbia	Burimi i të dhënave
1	Totali i popullsisë	Numër	7,186.862	Zyra e statistikave të Serbisë
2	Të ardhurat në nivel shtetëror	\$	5.820	Banka Botërore 2014
3	Gjenerimi i MNK për kokë banori	kg për ditë	0,9	Zyra e statistikave të Serbisë
4a	MNK e deponuar	%	65	
4b	MNK në deponi të hapura të paligjshme	%	20	Raporti mjed. SEPA për 2013
4c	Mbeturinat e rikthyera përmes riciklimit	%	15	Vlerësim
4d	Trajtimi biologjik MNK	%	0	-
4e	MNK e trajtuar në TMB	%	0	-
4f	MNK në trajtim termik	%	0	-
5	Përqindja e riciklimit	%	34	Kalkuluar në bazë të përbërjes së mbeturinave dhe 4c

<sup>23</sup> Mundësitë dhe barrierat e riciklimit në shtetet Ballkanike: rastet e Greqisë dhe Serbisë, ISWA 2012

<sup>24</sup> [http://www.un.org/esa/dsd/dsd\\_aofw\\_ni/ni\\_pdfs/NationalReports/turkey/Full\\_text.pdf](http://www.un.org/esa/dsd/dsd_aofw_ni/ni_pdfs/NationalReports/turkey/Full_text.pdf)

### 3.10 Turqia

Sipas Raportit shtetëror 2010 të Turqisë, për sesionin e 18-të të Komisionit për zhvillim të qëndrueshëm, zbatimi i menaxhimit të mbeturinave nga ana e komunave dhe komunave metropolitane në Turqi nuk ka arritur statusin optimal aspak. Përderisa grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave është bërë në shkallë të madhe pjesa më e madhe e mbeturinave në këtë shtet ende nuk është larguar në përputhje me ligjet dhe rregulloret<sup>24</sup>.

Në Turqi, legjislacioni primar që përbëhet prej ligjeve konstituohet në Parlamentin Turk dhe ekzekutohet nga Qeveria Turke përderisa legjislacioni sekondar përbëhet prej rregulloreve, komunikatave dhe qarkoreve që konstituohen dhe ekzekutohen nga Ministria korresponduese përgjegjëse. Legjislacioni sekondar për menaxhimin e mbeturinave definohet dhe zbatohet nga Ministria e Mjedisit dhe Urbanizimit (MMU). Legjislacioni sekondar kryesisht adaptohet me Direktivat e BE-

së dhe është në linjë me “ Strategjinë e integruar mjedisore të BE-së për Turqinë(2007-2023)”. Grupi vijues i legjislacionit primar rregullon menaxhimin e mbeturinave:

- ▲ Ligji mbi mjedisin nr. 2872
- ▲ Ligji për energjinë e ripërtëritshme nr. 534
- ▲ Ligji mbi komunat nr. 5393
- ▲ Ligji mbi komunat metropolitane nr. 5216

Sipas Ligjit për komunat metropolitane (10.7.2004-5216) dhe Ligjit për komunat (3.7.2005— 5393), përgjegjësia e plotë për menaxhimin e mbeturinave komunale i takon komunave. Ato janë përgjegjëse për sigurimin e të gjitha shërbimeve në lidhje me grumbullimin, transportimin, ndarjen, riciklimin, hedhjen dhe ruajtjen e mbeturinave të ngurta ose për të caktuar të tjerët që do të ofronin këto shërbime (ETC/SCP, 2009). Pa marrë parasysh, përderisa i përmbushin detyrat e tyre të grumbul-

limit dhe transportimit të mbeturinave të ngurta deri në një shkallë të gjerë ato nuk tregojnë nivelin e kërkuar të aktivitetit dhe vëmendje në menaxhimin e mbeturinave të ngurta komunale.

Komunat, drejtoritë rurale të Ministrisë e poashtu edhe Ministria e Mjedisit dhe Urbanizmit kanë rol në grumbullimin e të dhënave të MNK. Ministria e Mjedisit dhe Urbanizmit është përgjegjëse për menaxhimin e sistemit informativ MMNK. Të dhënat transferohen në Institucionin Turk për Statistika TURK-STAT, i cili më tutje publikon një Raport Vjetor për statistikat e mbeturinave. Ministria përgatitë raportet shtetërore dhe raportet për EEA.

Sipas të dhënave tëTURKSTAT2014, 58.14 % të mbeturinave të ngurta të gjeneruara janë dërguar në deponi sanitare dhe 32.44 % janë hedhur në deponi komunale. 0.41 % të MNK janë raportuar si të kompostuara në 6 fabrika kompostimi dhe 0.02 % janë trajtuar në 32 objekte për djegien e mbeturinave.

**Tabela 15:** Indikatorët shtetëror për mbeturina, Turqi

Numri i indikatorit	Indikator	Njësia	Turqi	Burimi i të dhënave
1	Totali i popullsisë	Numër	78,041.053	TurkStat 2014
2	Të ardhurat në nivel shtetëror	\$	10.389,7	TurkStat
3	Gjenerimi i MNK për kokë banori	kg për ditë	1,12	TurkStat 2014
4a	MNK të deponuara	%	58,14	TurkStat 2014
4b	MNK në deponi të hapura të paligjshme	%	32,44	TurkStat 2014
4c	Mbeturina të rikthyera prej riciklimit	%	5,77	TurkStat 2014
4d	Trajtimi biologjik MNK	%	0,41	TurkStat 2014
4e	MNK e trajtuar në TMB	%	0	TurkStat 2014
4f	MNK me trajtim termik	%	0,02	TurkStat 2014
5	Përqindja e riciklimit	%	n/a	TurkStat 2014

### 3.11 Studimi krahasimor i indikatorëve të nivelit shtetëror të MMN

#### Pasqyrë e përgjithshme e kornizës ligjore të nivelit shtetëror, përgjegjësiwe institucionale dhe grumbullimit të të dhënave për MMN

Shtetet në rajonin e Evropës Juglindore kanë përvojë të kufizuar në studimet krahasimore të menaxhimit të mbeturinave të ngurta. Ka disa të dhëna të disponueshme në nivel shtetëror si pjesë e statistikave nacionale ose si pjesë e raportimit mbi statusin mjedisor dhe raportimit për Agjencinë Evropiane Mjedisore (EEA). Këto shtete nuk kanë vendosur sistemin e grumbullimit të të dhënave ose procesimit të indikatorëve edhe pse grumbullimi i të dhënave dhe sistemi informativ MMN janë të rregulluara ligjërisht (Tabela 16).

Të dhënat e mbeturinave komunale nuk grumbullohen rregullisht. Shërbimet komunale të cilat ofrojnë grumbullim të mbeturinave të ngurta dhe shërbime procesimi

në SEE nuk kanë të dhëna të besueshme dhe të sakta për sasinë dhe përbërjen e mbeturinave të amvisërive të prodhuara nga banorët. Shifrat shpesh vlerësohen nga ndërmarrjet e shërbimeve komunale. Për këtë shkak, të dhënat e mbeturinave të ngurta duhet të merren parasysh me një shkallë të caktuar rezerve për shkak të metodologjive të grumbullimit të të dhënave dhe tërësisë së tyre. Cilësia e dobët e informatave të disponueshme i parandalon ata në organizimin adekuat të operimeve të tyre dhe raportimin e duhur për komuna dhe autoritetet e nivelit shtetëror, rezulton me planifikim dhe monitorim të dobët dhe pengon zbatimin aktual të standardeve të Bashkimit Evropian dhe caqeve të përcaktuara nga Direktivat e BE-së për menaxhim të mbeturinave. Cilësia e të dhënave për mbeturinat shtëpiake është sfidë për shërbimet komunale të cilat ofrojnë shërbime, komunat, të cilave u janë transferuar pjesa më e madhe e kompetencave në fjalë si dhe për autoritetet mbikëqyrëse dhe të tjera shtetërore përgjegjëse për dizajnimin e politikave dhe monitorimin e zbatimit të tyre në nivel shtetëror.

**Tabela 16:** Pasqyrë e shkurtër e situatës me kornizën ligjore, përgjegjësitë institucionale dhe nivelet e involvuara në grumbullimin e të dhënave


Shteti	Sistemi informativ MMNK / i rregulluar ligjërisht	Institucioni përgjegjës	Nivelet tjera të involvuara në grumbullimin e të dhënave janë:	Raportimi në EEA
Shqipëria	Po/Po	Agjencia për mbrojtje mjedisore	Komunat, rajonet, ministritë e linjës	po
Kosova	Po/Po	Agjencia për mbrojtje mjedisore	Komunat	jo
Moldavia	Jo	Zyra e statistikave	Komunat	jo
Bosnje dhe Hercegovina	Jo (Entiteti Republika Srpska, entiteti Federata e Bosnje dhe Hercegovinës – vetëm operatorët privat të mbeturinave)	Agjencitë e mbrojtjes së mjedisit dhe Zyrat statistikore	Komunat, rajonet, ministritë e linjës, kompanitë e menaxhimit të mbeturinave	jo
Maqedonia	Po/Po (pa legjislacion sekondar)	Qendra e informatave mjedisore të Maqedonisë (MEIC) (i përket Ministrisë)	Komunat	po
Serbia	Po/Po	Agjencia për mbrojtje të mjedisit dhe Zyra e statistikave	Komunat, prodhuesit e mbeturinave, Ministria, operatori i pikës së trajtimit	jo
Bullgaria	Po/Po	Agjencia për mbrojtje të mjedisit dhe Zyra e statistikave	Komunat	po
Rumunia	Po/Po	Agjencia për mbrojtje të mjedisit		po
Mali i zi	Po/Po	Agjencia për mbrojtje të mjedisit dhe Zyra e statistikave	Komunat	
Kroacia	Po/Po	Agjencia për mbrojtje të mjedisit		po
Turqia	Po/Po	Ministria e Mjedisit dhe Urbanizimit, Zyra Statistikore	Komunat, Drejtoria rurale e Ministrisë, dhe Ministria e Mjedisit dhe Urbanizimit	po



## Studimi krahasimor i indikatorëve MMN të nivelit shtetëror

Kur krahasojmë BPV për kokë banori, shtetet në rajon janë në situatë të ngjashme ekonomike, përveç Turqisë e cila e ka BPV pothuajse dy herë më të lartë sesa shtetet tjera të studiuara me 7,819 EUR për kokë banori, përcjellur nga Rumania me 7,500 EUR, përderisa gjashtë shtete kanë më pak se 5000 Euro për kokë banori.


Për qëllime të të kuptuarit të korrelacionit potencial të BPV dhe gjenerimit të MMN, ne shtojmë vlerat e BPV dhe gjenerimit të MMN për 7 shtete tjera dhe BE 28.



**Tabela 17:** Gjenerimi i MMN dhe BPV për kokë banori për 7 shtete tjera dhe BE 28

	Sllovenia	Irlanda	Polonia	Malta	BE 28	Maroku	Gjeorgjia	Egjipti
Gjenerimi i MMN	1,23	1,61	0,89	1,61	1,3	0,57	0,87	0,70
BPV për kokë banori	19.110,5	46.633,2	11.304,6	29.200	30.240	4.910	5.390	6.000



Grafiku 4 Korrelacioni i gjenerimit të MMN (kg për kokë banori) dhe BPV në\$ për kokë banori



Për BPV për kokë banori nën 10,000 \$, gjenerimi i MMN është në shkallën 0.6- 1.2 kg. Rritja e madhe e kësaj shkalle nuk do të thotë automatikisht rritje e madhe në gjenerimin e MMN. Malta dhe Irlanda me BPV 3 dhe 4 herë më të lartë kanë 1.6 kg të mbeturinave të gjeneruara për kokë banori. Megjithatë, për proceset e vendimmarrjes dhe selektimin e skenarëve më të përshtatshëm të MMN, ne duhet të dimë totalin e mbeturinave të gjeneruara në baza vjetore. Sasia e vogël e mbeturinave të gjeneruara brenda një shteti do të kufizojë aplikimin e kapacitetit të lartë dhe rikthimin kompleks të mbeturinave ose infrastrukturën e trajtimit të mbeturinave.

Përveç Turqisë dhe Rumanisë, të gjitha shtetet tjera kanë një gjenerim shumë të vogël vjetor pra më pak se 5,000,000 t/vit (Grafiku 5).


Përveç numrit total të popullsisë që është më i lartë në krahasim me shtetet tjera, Rumunia dhe Turqia, së bashku me Bullgarinë kanë një gjenerim shumë më të madh të mbeturinave për kokë banori për ditë (Grafiku 6).

**Grafiku 5** Korrelacioni i numri të popullsisë me sasinë e mbeturinave të gjeneruara, t/vit**Grafiku 6** Gjenerimi i MNK për kokë banori, në kg/ditë

Opsioni më i preferueshëm për shumicën e shteteve ende është vendosja e mbeturinave në deponi sanitare ose komunale ose në vendhedhje të paligjshme (Grafiku7). Shumica e shteteve kanë afër 90% ose më tepër mbeturina të hedhura në deponi në krahasim me BE-28 që në 2012 kanë pasur pothuajse gjysmën (48.3 %) e mbeturinave të


deponuara. Raportohet se në Shqipëri pothuajse 60% të mbeturinave të gjeneruara janë të hedhura në deponi të egra. Deponimi i paligjshëm nuk është raportuar zyrtarisht në Kosovë dhe Maqedoni edhe pse një numër i projekteve po merren me veprime të pastrimit në të dyja shtetet.

**Grafiku 7** MNK të deponuara përkundër MNK të hedhura në deponi të egra



Grafiku 8

Rikthimi i mbeturinave për shtet, %



Rikthimi i prezantuar i mbeturinave (Grafiku 8) është i barabartë me shumën e vlerave të indikatorëve 4c–Mbeturinave të rikthyera përmes riciklimit dhe 4d–Trajtimi biologjik i MNK (Tabela 7) që do të thotë riciklimi, trajtimi biologjik, TMB dhe trajtimi termik. Rikthimi i mbeturinave nuk ekziston në Moldavi përderisa shtetet tjera kanë raportuar 0.26 % (Maqedoni) deri në 15 % (Serbi).

Vlera e këtij indikator nuk është e krahasueshme me vlerën e prezantuar për BE 28, pasi vlera prej 36.4 % ndërlidhet me përqindjen e mbeturinave të trajtuara në BE-28 në vitin 2012 përderisa indikator 4c-4d ndërlidhet me mbeturinat e gjeneruara. E njëjta vlen për 6.0 % të mbeturinave të trajtuara në BE–28 që dërgohen për djegie. Bullgaria ka paraqitur pilot projektin e kompostimit në 19 komuna dhe rezultati është 30% kompostim i mbeturinave të gjeneruara. Në 6 fabrika të kompostimit, Turqia trajton 0.41% të mbeturinave të saj të gjeneruara. Bullgaria rikthen energjinë nga 20% të mbeturinave të veta të gjeneruara, në Sofia në centralin e kombinuar të ngrohjes dhe energjisë. Turqia rikthen 0.02 % në 32 qendra të insinerimit –djegies. TMB është prezent në Bosnje dhe Hercegovinë.



# Rishikimi i menaxhimit të mbeturinave të ngurta në komuna

4




## 4.1 Komuna e Lezhës (Shqipëri)

Komuna e Lezhës ka popullsinë prej 107,873 në total, prej së cilës 38.6 % janë në zonën e saj urbane. Zona e saj urbane është rreth 100 km<sup>2</sup>, që përfaqëson 50% të territorit të saj total. Gjenerimi i MNK për kokë banori është 0.7 kg/ditë.


Popullsia e mbuluar me shërbimet MNK në zona urbane është 92.8%, përderisa në zona rurale përqindja është shumë më e ulët, që do të thotë 44.3%. Përqindja e riciklimit është e madhe dhe e vlerësuar me 28%. Ky është rezultat i dy projekteve “Zhvillimi i planit të menaxhimit të mbeturinave dhe ndërtimi i qendrës për ndarje dhe riciklim në komunën e Lezhës” dhe “Menaxhimi pjesëmarrës në pastrimin e plastikës dhe menaxhimin e mbeturinave në komunën e Lezhës”.

Grafiku 9

Proporcioni i popullsisë në zona rurale dhe urbane, Lezhë (Shqipëri)




Grafiku 10 Niveli i shërbimit MNK, Lezhë (Shqipëri)





Mbeturinat përbëhen kryesisht nga mbeturinat e biodegradueshme të kopshteve– 44.3%,përderisa ka edhe paketim plastik të mbeturinave në sasi prej 10% dhe kartuç në sasi prej 9%.

**Grafiku 11** Përbërja e MNK,Lezhë(Shqipëri)




## 4.2 Komuna e Prijedorit (Bosne dhe Hercegovinë)

Në komunën e Prijedorit jeton popullata prej 97,588 në total, prej të cilëve 53 % janë në zonën e tij urbane. Zona e tij urbane është rreth 14.3 % të 834 km<sup>2</sup> të territorit të tij në total. Popullsia e mbuluar me shërbime MNK në zonë urbane arrin 88 %, përderisa në zona rurale është shumë më e ulët, që do të thotë 28%.

Gjenerimi i MNK është 1.6 kg/ditë për kokë banori nga shtëpitë dhe 9.73 kg/ditë nga burimet komerciale.


Grafiku 12

Proporcioni i popullsisë në zona rurale dhe urbane, Prijedor (Bosnje dhe Hercegovinë)




Grafiku 13

Niveli i shërbimit MNK, Prijedor (Bosne dhe Hercegovinë)



Mbeturinat përbëhen kryesisht nga mbeturinat e biodegradueshme – 61.3%, përdërisa letra arrin në 8%. Për sa i përket qeseve të plastikës, përqindja është mjaft e madhe 6.3% e poashtu edhe e kanaqeve të aluminit—7.9%. Rreth 44 % të popullsisë mbulohen nga shërbimi i paketimit të mbeturinave. Megjithatë përqindja e riciklimit në Prijedor është ende e ulët, vetëm 2.8%.

**Grafiku 14** Përbërja e MNK në %, Prijedor (Bosne dhe Hercegovinë)




### 4.3 Komuna Cazin (Bosnje dhe Hercegovinë)

Komuna Cazin ka sipërfaqe totale prej 356 km<sup>2</sup>. Sipërfaqja e zonës së urbanizuar nuk është e disponueshme. Në komunën Cazin jetojnë 69,411 banorë në total , përdërisa vetëm 17,750 jetojnë në zonën urbane të komunës. Gjenerimi i MNK është 0.42 kg/ditë për kokë banori.

Popullsia e mbuluar me shërbimet MNK në zona urbane arrijnë 100% përdërisa në zona rurale ka rezultat më të ulët, d.m.th. 77% , përdërisa shërbimi i paketimit të mbeturinave nuk është siguruar fare. Andaj, përqindja e riciklimit në Cazin është 0%.


Grafiku 15

Proporcioi i popullsisë në zona rurale dhe urbane, Cazin (Bosnje dhe Hercegovinë)




Grafiku 16

Niveli i shërbimit MNK, Cazin (Bosnje dhe Hercegovinë)



Përqindja e mbeturinave të biodegradueshme dhe të mbeturinave të kopshteve është e lartë, me 57% në total. Letra, kartuçi dhe xhami përbëjnë rreth 4%, përderisa përqindja e metaleve, pelenave dhe lëkurës është rreth 4%. Ka një proporcion mjaft të lartë të mbeturinave të ndërtimtarisë të përziera me mbeturina medicinale dhe të rrezikshme.

**Grafiku 17** Krahasimi i MNK, Cazin (Bosne dhe Hercegovinë)




#### 4.4 Komuna Gabrovo (Bullgari)

Në komunën Gabrovo jetojnë në total 60,772 banorë, prej të cilëve 92% janë në zonë urbane. Zona urbane zë rreth 42% të territorit të vet total (555580km<sup>2</sup>). Informatat rreth gjenerimit të MNK nuk janë të disponueshme.

Popullsia e mbuluar me shërbimet MNK në zona urbane dhe rurale është 99%. Sipas të dhënave të siguruar nga NALAS TFM, rreth 99% të popullsisë është e mbuluar me shërbimin e grumbullimit të paketimit të mbeturinave. Megjithatë, përqindja e riciklimit në Gabrovo është ende e ulët dhe arrinë vetëm 6.8%.


Grafiku 18

Proporcioni i popullsinë në zona rurale dhe urbane, Gabrovo (Bullgari)




Grafiku 19

Niveli i shërbimit MNK, Gabrovo (Bullgari)



Mbeturinat kryesisht përbëhen nga mbeturinat e biodegradueshme- 40% , përderisa plastika e fortë përbën rreth 9%. Ka një përqindje të lartë të qeseve të plastikës – 6.3%, dhe kanaqeve të aluminit – 7.9%. Komponentët tjerë sikurse letra, xhami, tekstili dhe lëkura janë në shkallën 2.5 dhe 5%.

Grafiku 20 Përbërja e MNK, Gabrovo (Bullgari)




## 4.5 Komuna Bijelo Polje (Mali i Zi)

Në komunën Bijelo Polje jetojnë 46,051 banorë në total, prej të cilëve 67 % janë në zona të tyre urbane. Zonat urbane zënë rreth 29.8 % të 924 km<sup>2</sup> të territorit në total. Popullsia e cila mbulohet nga shërbimet e MNK në zonë urbane arrijnë 100 %, përdërisa në zona rurale është shumë më e ulët, që do të thotë 8%.

Gjenerimi i MNK për kokë banori është 0.95 kg/ ditë.


**Grafiku 21**

Proporcioni i popullsisë në zonat rurale dhe urbane, Bijelo Polje (Mali i Zi)



**Grafiku 22**

Niveli i shërbimit MNK, Bijelo Polje (Mali i Zi)





Nuk ka ndonjë informatë për përqindjen e riciklimit dhe mbulimit përmes shërbimeve të riciklimit. Mbeturinat përbëhen kryesisht nga mbeturinat e biodegradueshme—47%,përderisa letra arrinë në 13.5% dhe xhami në 8.8%. Përqindja e plastikës së fortëështë mjaft e lartë- 12.3%.Të dhënat e siguruara janë fituar nga institucionet shtetërore si tipike për rajonin (Pjesa veriore e Malit të Zi). Nuk ka të dhëna të disponueshme nga Komuna pasi që ato nuk ofrojnë shërbime për grumbullim të veçantë të mbeturinave ose ndonjë lloj tjetër të riciklimit.



**Grafiku 23** Përbërja e MNK, Bijelo Polje (Mali i Zi)



### 4.6 Komuna Ferizaj (Kosovë)

Në komunën e Ferizajt jetojnë 108.610 banorë në total, prej të cilëve 45 % jetojnë në zona urbane. Zona urbane është rreth 45 % të 315 km<sup>2</sup> të territorit në total. Popullsia e mbuluar me shërbimet MNK në zona urbane është 80% përdherisa në zona rurale është 63%.

Gjenerimi i MNK për kokë banori është 0,56 kg/ditë.



Nuk ka ndonjë informatë për përqindjen e riciklimit dhe mbulimin nga shërbimet e riciklimit në Komunën e Ferizajt. Ndërmarrjet komunale kanë vlerësuar se letra përbën 15% të mbeturinave përderisa përqindja e komponentëve tjerë të riciklueshëm është raportuar të jetë zero. Pjesa e mbetur e 85% janë mbeturina të biodegradueshme. Nëse e marrim parasysh se një përqindje e xhamit, plastikës, metaleve dhe llojeve tjera të mbeturinave është e pritshme, kjo mund të merret si një vlerësim shumë i përgjithshëm.


#### 4.7 Komuna e Kumanovës (Maqedoni)

Në komunën e Kumanovës jetojnë në total 108,048 prej të cilëve 72% jetojnë në zonën urbane. Totali i sipërfaqes së komunës është 509.5 km<sup>2</sup>.

Popullsia e mbuluar me shërbimet MNK në zonë urbane përbën 100% përdërisa në zonë rurale kjo përqindje është ekstrem e ulët— 4%. Shifra e popullsisë së mbuluar me shërbimet e grumbullimit të paketimit të mbeturinave dhe përqindja e riciklimit nuk janë të disponueshme. Shifrat e gjenerimit të MNK nuk janë të disponueshme.


Grafiku 26

Raporti i popullsisë në zona rurale dhe urbane, Kumanovë (Maqedoni)



Grafiku 27

Niveli i shërbimit MNK, Kumanovë (Maqedoni)



Mbeturinat përbëhen kryesisht nga mbeturinat e biodegradueshme – 47.5%. Përqindja e qeseve të plastikës është shumë e lartë– 7.5%.

**Grafiku 28** Përbërja e MNK, Kumanovë (Maqedoni)



## 4.8 Komuna Pančevo (Serbi)


Në komunën Pančevo jetojnë në total 122,252 banorë prej të cilëve 73% jetojnë në zonën urbane. Zona urbane zë rreth 19.3 % të territorit total prej 756 km<sup>2</sup>.

Gjenerimi i MNK për kokë banori është 0.57 kg/ditë për kokë banori.

Popullsia e mbuluar nga shërbimet e grumbullimit MNK në zona urbane është 100% përderisa ky indikator për zonën rurale është 96.8%.


Grafiku 29

Raporti i popullsisë në zonat rurale dhe urbane, Pančevo (Serbi)



Grafiku 30

Niveli i shërbimit MNK, Pančevo (Serbi)



Shifra e mbulimit nga shërbimet e grumbullimit të paketimit të mbeturinave nuk është siguruar mirëpo përqindja e riciklimit në Pančevo është rreth 6.5%. Mbeturinat përbëhen kryesisht nga mbeturinat e biodegradueshme—47%, ndërsa letra dhe mbeturinat e paketimit plastik arrijnë në rreth 12.6%, secila. Përqindja e qeseve të plastikës është mjaft e lartë— 6.3% dhe e kanaqeve të aluminit—7.9%.

**Grafiku 31** Përbërja e MNK, Pančevo (Serbi)



## 4.9 Komuna Uzunköprü (Turqi)

Në Komunën Uzunköprü jetojnë në total 64,322 banorë, prej të cilëve 63% jetojnë në zonën urbane të komunës. Zona urbane zë rreth 16 % të territorit total prej 1,212 km<sup>2</sup>.


Gjenerimi i MNK për kokë banori është 1.5 kg/ditë.

Popullsia e mbuluar me shërbimet MNK në të dyja zonat, rurale dhe urbane arrinë 100%.

Rreth 62 % të popullsisë është e mbuluar nga shërbimi i grumbullimit të paketimit të mbeturinave. Përqindja e riciklimit në Uzunköprü është e lartë—37%.


Grafiku 32

Raporti i popullsisë në zonat rurale dhe urbane, Uzunköprü (Turqi)



Grafiku 33


Niveli i shërbimit MNK, Uzunköprü (Turqi)





Mbeturinat përbëhen kryesisht nga mbeturinat e biodegradueshme – 46.1%,përderisa letra përbën rreth 6%. Përqindja e paketimit nga plastika është mjaft e lartë– 12.5%.

**Grafiku 34** Përbërja MNK, Uzunköprü (Turqi)



#### 4.10 Komuna Targoviste (Rumuni)


Në komunën Targoviste jetojnë 89,000 banorë në total, prej të cilëve 90% jetojnë në zonë urbane. Zona urbane është rreth 84.4 % të territorit total 769 km<sup>2</sup>. Popullsia e mbuluar me shërbimet MNK në të dyja zonat, urbane dhe rurale është 100%.

Gjenerimi i MNK për kokë banori është 1.5 kg/ditë.

Rreth 17 % të popullsisë është mbuluar nga shërbimet e grumbullimit të paketimit të mbeturinave. Megjithatë përqindja e riciklimit në Targoviste nuk është prezantuar. Mbeturinat përbëhen kryesisht nga mbeturinat e biodegradueshme—50%, ku ka raport të barabartë të letres, tekstilit dhe lëkurës (5%).


Grafiku 35

Raporti i popullsisë në zonën rurale dhe urbane , Targoviste (Rumuni)



Grafiku 36


Përbërja e MNK , Targoviste (Rumuni)



## 4.11 Komuna Soldanesti (Moldova)

Sipas të dhënave të prezantuara në Studimin e Fizibilitetit për qendrën e menaxhimit të mbeturinave të ngurta në Soldanesti<sup>25</sup>, numri total i popullsisë është 37,774. Popullsia e mbuluar me shërbimet MNK në zonën urbane është 98% përderisa në zonën rurale është shumë më e ulët -76%.

Gjenerimi i MNK për kokë banori është 0.71 kg/ditë.



Sipas të dhënave të prezantuara në Studim, pjesa më e madhe e përbërjes së mbeturinave është raportuar të jetë “mbetje”/ Mbetjet janë ndarë në “ të përziera organike dhe inorganike” dhe “inerte” (Figura 2-4 e Studimit). Pasi që klasifikimi i përbërjes së mbeturinave nuk është i njëjti sikurse ai që është përdorur në metodologjinë për qëllime të krahasimit, është e vështirë të përdorim këto rezultate për krahasim regional. Ka prezencë të vogël të qeseve të plastikës (9%), xhamit (3.6%) dhe letres (5.6%).

**Tabela 18:** Përbërja e MNK, Soldanesti, Moldavi<sup>24</sup>

	Mbeturinat tjera të biodegradueshme (%)	Mbeturinat tjera të biodegradueshme (%)	Mbeturinat tjera të biodegradueshme (%)
Mbetjet	81,1	82,3	81,7
Letra	5,6	5	5,3
Xhami	3,5	3,7	3,6
Metali-paketimi etj	0,7	0,6	0,65
Qeset e plastikës	9,1	8,4	8,75

Raportet e studimit tregojnë se 98 % e popullsisë është e mbuluar me shërbimet e grumbullimit të paketimit të mbeturinave të organizuara në 53 platforma. Secila platformë ka 7 kontejnerë për lloje të ndryshme të mbeturinave në zonën urbane dhe 4 kontejnerë në zonën rurale. Megjithatë, përqindja e riciklimit në Soldanesti nuk është prezantuar.


<sup>25</sup> Studimi i Fizibilitetit është përgatitur brenda programit „ Modernizimi i shërbimeve lokale publike në Republikën e Moldavisë” GIZ.

## 4.12 Studimi krahasimor indikatorëve të MMN në nivel lokal

Komunat e përfshira në studimin krahasimor kanë numër të popullsisë prej 35,000 deri 125,000.


Pjesa më e madhe e popullsisë në Gabrovo dhe Targoviste, Kumanovë dhe Pancevojeton në zona urbane të komunës përderisa nëCazin dhe Bijelo Polje, madje edhe në Lezhë , pjesa më e madhe e popullsisë jeton në zona rurale. Prijedor dhe Ferizaj kanë popullsi të balancuar urbane dhe rurale (Grafiku 38). Shifrat në raportin ndërmjet numrit të popullatës që jeton në zonë urbane dhe asaj që jeton në zonë rurale për Komunën Soldanesti (Moldavi) nuk janë të disponueshme.

**Grafiku 38** Raporti ndërmjet numrit të popullsisë që jeton në zona rurale dhe urbane




Shifrat për gjenerimin e MNK në komunat e Ferizajt (Kosovë) dhe Kumanovës (Maqedoni) nuk ishin të disponueshme (grafiku 39). Për sa i përket nivelit shtetëror, Turqia dhe Rumunia kanë raportuar gjenerim të lartë të MN (1.5). Ne kemi supozuar se duhet të ketë një korrelacion ndërmjet % së popullsisë urbane dhe gjenerimit të MNK për kokë banori (Grafiku 40). Megjithatë bazuar në të dhënat e disponueshme për 8 komuna ky korrelacion nuk mund të vendoset.

**Grafiku 39** Gjenerimi i MNK (kg/person/ditë)




Komuna Gabrovo (Bullgari) ka raportuar vetëm 0.4 kg/ditë për madje 91.7% ë popullatës së vet të zonës urbane ndërsa Targoviste në Rumuni pothuajse për të njëjtin numër të popullsisë urbane ka raportuar (90%) 1.5 kg/ditë. Pančevo (Serbi) ka raportuar 0.57 me 74.3 % të popullsisë urbane.


**Grafiku 40** Korrelacioni ndërmjet popullsisë urbane dhe gjenerimit të MNK për kokë banori



Mbulimi me shërbimin MNK nuk është nën 80% në zona urbane (Grafiku 41). Megjithatë, territori urban është shumë më i vogël se sa territori rural përveç në Targoviste dhe Soldanesti (Grafiku 38). Përqindjet urbane për Kumanovë dhe Cazin nuk ishin të disponueshme.



Mbulimi i shërbimit MNK në zona rurale nuk është i kënaqshëm, përveç në Targoviste dhe Uzunkopru. Bijelo Polje, Kumanovo, Prijedor dhe Lezha kanë mbulim shumë të ulët në zonat e tyre rurale dhe një numër të madh të popullatës që jeton në këto zona. Në këto rrethana, komunat shpeshherë vuajnë prej problemit të deponive të egra. Në rastin e Lezhës, 98.2% janë zona rurale ku jetojnë 61.4% të popullsisë dhe mbulimi është vetëm 44.2%. Kjo jep një numër prej 8.8 mijë tonë të mbeturinave të pagrumbulluara të cilat përfundojnë në deponi të egra në zona rurale. E njëjta vlen për zonat tjera rurale me mbulim të dobët.



Shifrat e raportuara për popullsinë e mbuluar nga shërbimet e paketimit të mbeturinave në Prijedor dhe Gabrovo janë shumë të larta përderisa në të njejtën kohë përqindja e riciklimit është nën 10% (Tabela 19).

**Tabela 19:** Përqindja e riciklimit dhe popullsisë së mbuluar nga shërbimi i paketimit të mbeturinave


	Popullsia e mbuluar nga shërbimi i paketimit të mbeturinave	Përqindja e riciklimit
Shqipëria (Lezhë)	6,03	28
BH (Prijedor)	43,86	2,78
BH (Cazin)	0	
Bullgaria (Gabrovo)	99	8,86
Mali i Zi (Bijelo Polje)	0	0
Kosova (Ferizaj)	N/P	N/P
Maqednia (Kumanovë)	N/P	N/P
Serbia (Pancevo)	N/P	1,4
Turqia (Uzunkopru)	62	37
Rumunia (Targoviste)	17	
Moldavia (Soldanesti)	84	30

Përqindja e riciklimit dhe mbulimit nuk ishte e disponueshme për Ferizaj dhe Kumanovë. Megjithatë, sipas raportit të USAID-it<sup>26</sup>, në Kosovë ka industri të madhe të riciklimit të plastikës dhe pjesa më e madhe e kompanive është në qytetet më të mëdha të Kosovës: Ferizaj, Prishtinë, Shtimje, Lipjan, Prizren, Podujevë, etj. Numri total i kompanive në këto qytete është 15, 7 prej të cilave gjinden në Ferizaj. Ferizaj, poashtu është përfshirë në pilot programin e riciklimit.

<sup>26</sup> Aktiviteti i riciklimit të plastikës në Kosovë, USAID tetor 2009

Mbeturinat e kopshteve dhe mbeturinat tjera të biodegradueshme përbëjnë pjesën më të madhe të MNK, prej 22% në 22% në Pančevo (Serbi) deri në 85% në Ferizaj (Kosovë). Shifrat e raportuara për Kosovë duhet të merren parasysh me rezerva pasi që nuk e kanë raportuar ndonjë komponentë tjetër përveç letres dhe mbeturinave të biodegradueshme (Grafiku 43). Përkundër potencialit të lartë për rikthim në të gjitha rastet, ato hedhen në deponitë komunale..


**Grafiku 43** Përbërja e mbeturinave në 10 pilot komuna






Komuna Pančevo (Serbi) ka raportuar sasinë më të madhe të letrës dhe kartuçit, 37% prej së cilës 23% është letër. Shtetet tjera kanë raportuar 6-17% letër dhe kartuç në total (Grafiku 44). Duke marrë parasysh gjenerimin e mbeturinave në komunat e selektuara, kemi komunat Cazin, Gabrovo dhe Soldanesti me nën 1000 t/vit, Prijedor, Bijelo Polje dhe Uzunkopru me rreth . 3000 t/vit dhe Targoviste me rreth 4000t/vit.Vetëm Pančevo ka raportuar rreth 10000 t/vit. Në përgjithësi, në të gjitha komunat, sasia e letrës dhe kartuçit të gjeneruar nuk është e madhe (Grafiku 45).

**Grafiku 44** Raporti i letrës dhe kartuçit në përbërjen e mbeturinave në komunat e zgjedhura, %



**Grafiku 45** Sasia e letërës dhe kartuçit në përbërjen e mbeturinave në komunat e selektuara, t/ vit



# ORGANIZATAT PARTNERE

5



Implemented by:  
**giz** Deutsche Gesellschaft  
für Internationale  
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Organizatat, institucionet dhe kompanitë të cilat i kanë dhënë mbështetje të madhe NALAS-it dhe asociacioneve të saj anëtare njihen si Partner NALAS. Mbështetja e tyre mund të përfshijë, mirëpo nuk është e kufizuar në, lobimin për NALAS dhe anëtarët e saj, mbështetje me ekspertizë dhe mbështetje financiare. Gjithashtu NALAS ka dëshmuar se është aset i vlefshëm për shumë prej këtyre partnerëve, duke siguruar përvojë regjionale, udhëzime ose koordinim të aktiviteteve të zhvilluara në shtetet anëtare.

Metodologjia e studimit krahasimor të NALAS-it për MNK e zbatuar në 2015 dhe raporti i tij janë mundësuar përmes fondeve të siguruar nga Projekti “ Grumbullimi i të dhënave për mbeturina të ngurta nëEJL”, financiarisht i mbështetur nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe zhvillim (BMZ) dhe Qeveria Zvicerane, zbatuar nga GIZ përmes Fondit të hapur rajonal për modernizim të shërbimeve komunale (ORF MMS). Projekti është zbatuar në katër pilot komuna të SEE – Maqedoni, Serbi, Malit të zi dhe Bosne dhe Hercegovinës, si përpjekje e përbashkët e partnerëve kyç të projektit: NALAS – Rrjeti i asociacioneve të autoriteteve lokale të Evropës Juglindore, Asociacioni për sektorin e ujërave dhe mbrojtjes mjedisore” Rrjeti Aquasan në BeH” dhe SeSWA – Asociacionit Serb për mbeturina të ngurta.



Network of Associations  
of Local Authorities  
of South East Europe









NALAS

NALAS

NALAS

NALAS

NALAS

NALAS

NALAS

NALAS

NALAS

NALAS

NALAS

NALAS

